

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 10 MARS 2022

Thonë se ka dy gabime, që mund të bëhen rrugës për të zbuluar të vërtetën. E para, të mos i shkosh deri në fund të vërtetës. E dyta, të mos nisësh fare për ta zbuluar të vërtetën. Në fakt, për 45 minuta u përballëm përsëri me opozitën, e cila asnjëherë nuk u nis për të zbuluar të vërtetën dhe asnjëherë nuk donte të përballej me të vërtetën, sepse, si rëndom në këta 8 vjet e më tepër, opozita i merr me mend të vërtetat. Opozita pretendon t'u japë jetë gënjeshtrove, gënjeshtrove që bëhen enkas aq të mëdha, që të besohen se mund t'i japin oksigjen edhe një partie në degradim e sipër. Megjithatë, është rasti për ta falënderuar opozitën, sepse i dha mundësinë publikut që të kuptojë edhe një herë se çështja e mjedisit, nuk është çështja e strategjive që bëhen për mjedisin, por çështja e mjedisit është ajo që prekim, është ajo që shohim, është ajo që mendojmë çdo ditë si qytetarë kur ecim rrugëve, kur frekuentojmë sheshet, parqet, detet, lumenjtë, liqenet dhe malet e këtij vendi. Pretendojmë të përballemi me një mjedis të pastër, pretendojmë të përballemi me një mjedis të gjelbër, kërkojmë të kemi cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit, por a i kemi pasur këto gjëra? Nuk i kemi pasur. A është bërë ndonjë përpjekje për t'i pasur këto gjëra për sa kohë ju ishit në qeverisje? Zero përpjekje.

Sapo filluam përpjekjet reale dhe në terren sapo filluan të materializohen përpjekjet reale, dolët ju me gënjeshttrat tuaja, që u ripërsëritën edhe në këto 45 minuta. Jo, rastësisht, as në përmbledhjen që u lexua në komisionin hetimor parlamentar nga ana e opozitës dhe as në përmbledhjen që u lexua sot, sepse sërish nuk dëgjuam një raport, sërish nuk u lexua një raport, nuk iu referuat asnjë neni, asnjë ligji, që pretendohet të jetë shkëlur dhe për rrjedhojë të vërë në presupostin zyrtarë shtetëror se kanë kryer vepra penale. Sidoqoftë, unë shpresoj që, nëpërmjet leximit edhe një herë të raportit të përgatitur nga përfaqësuesit e shumicës në komisionin hetimor parlamentar, të kuptojmë se çfarë ka ndodhur dhe të kuptojmë edhe një herë se përse opozita u fut në këtë përpjekjen e shprehjeve bombastike të vjedhjeve galopante që paska kryer maxhoranca. Ky komision hetimor u ngrit me kërkesë të opozitës, e cila u pranua. Por dua të sjell në vëmendje të të gjithëve se nuk ndodhi sikundër jemi përballur ne deputetët e shumicës vite më parë, kur kërkesave tona për ngritje të komisioneve hetimore u thuhej stop nëpërmjet justifikimeve dhe argumenteve të pafund.

Njëkohësisht, opozita pati të gjithë tolerancën nga ana e maxhorancës që për 4 muaj të kishte në dispozicion të gjitha të dhënat për ndërtimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve, të kishte mundësinë të pyeste çdo dëshmitar që pretendonte të pyeste për këtë çështje. Hetimi, sipas vendimit nr.81 të Kuvendit, synonte nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, garantimin e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut të lirë dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis më të pastër. Sipas këtij vendimi, komisioni hetimor duhet të bënte transparencë për çdo çështje të përfshirë në objektin e veprimtarisë. Detyrat e komisionit ishin: të kontrollonte veprimet dhe mosveprimet e organeve publike, edhe një herë e përsëris, e organeve publike, të përfshira në ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve; verifikimin e pasojave që secila procedurë ka pasur në buxhetin e shtetit, si dhe vlerësimin se cilat ishin procedurat më eficiente për ndërtimin e tre

inceneratorëve; verifikimin e pasojave që secila prej procedurave të mësipërme ka pasur në buxhetin e shtetit dhe kryerjen e vlerësimit se cilat do të ishin procedurat më eficiente për ndërtimin e tre inceneratorëve; verifikimin e pasojave që ndërtimi i impianteve ka sjellë në mjedis; vlerësimin e nevojës për ndërhyrje ligjore, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës, tregut të lirë, mjedisit dhe përafrimin e legjislacionit me BE-në.

Besoj se askush dëgjoji ndonjë nga këto të dhëna në raportin e referuar nga ana e opozitës. Siç e thashë, komisioni u angazhua për katër muaj në mbledhjen e të gjitha të dhënave që pretendoi opozita, të dhëna të cilat janë vënë në dispozicion nga organet e administratës shtetërore në masën 100%, përveç të dhënave që opozita pretendon se nuk i ka marrë, sigurisht, opozita dhe parlamenti nuk mund të marrë asnjë të dhënë nga ato që ligji ia ndalon t'i marrë. Ajo që dua të ndaj, që në krye të kësaj fjale, është fakti që ne në komisionin hetimor, si përfaqësues të maxhorancës, pretenduam vijimisht që komisioni parlamentar të ishte në shinat e zhvillimit të një hetimi të vërtetë parlamentar, por kjo linjë u kapërcye shumë herë, u kapërcye gjatë gjithë kohës nga ana e opozitës, sepse ajo u përpoq dhe në vetvete paraqiti përballë publikut një hetim penal, të cilin Kuvendi i Shqipërisë nuk mund ta bënte, sepse e ka të ndaluar nga Kushtetuta. Ekskluzivitetin e ndjekjes penale në vend dhe të ngritjes së akuzës nuk e ka Kuvendi i Shqipërisë, por e ka pushteti gjyqësor, prokuroria. Deri në vitin 2013 situata mjedisore në Shqipëri ishte në gjendje katastrofike. Menaxhimi i mbetjeve nuk konsiderohej nga askush as si prioritet, as si një urë lidhëse për zhvillimin ekonomik të vendit dhe as për zhvillimin e turizmit, ndërkohë që sot kjo është bërë tema e ditës.

Përpara vitit 2013 panorama e menaxhimit të mbetjeve paraqitej e tillë: Trashëguam venddepozitime nga ishkomunat, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë të vendosura brigjet e lumenjve apo në vende që ishin jashtë çdo standardi mjedisor, duke ndotur lumenj dhe dete. Sot po shohim se venddepozitime të tilla jo vetëm janë mbyllur dhe po vijojnë që të mbyllen. Nuk ka pasur metodologji të qartë dhe të unifikuar për të përcaktuar se sa kushton menaxhimi i mbetjeve. Lejohej importi i një liste mbetjesh, por sistemi i kontrollit nuk ka qenë në nivelin që duhej dhe për këtë arsye gjithmonë është dyshuar që në vend kanë hyrë edhe mbetje të rrezikshme. Shërbimi i pastrimit ishte i kufizuar dhe këtë ne nuk kemi si ta mohojmë, sepse ne jemi deputetë të zgjedhur në zonat tona elektorale dhe e dimë shumë mirë që një nga pretendimet kryesore që kanë zgjedhësit tanë në takimet me to është pikërisht ajo që lidhet edhe me pastrimin. Kishte pamjaftueshmëri financiare, që reflektohej në një mungesë të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve dhe flasim për një infrastrukturë moderne, me standarde. Në buxhetin e viti 2022 ka një fond prej 500 milionë lekësh të rinj, që është vënë në dispozicion të trajtimit dhe të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Pas 2013-ës kjo problematikë u bë më imperative për maxhorancën për ta zgjidhur.

Këtu shumë shpesh u lakua një vendim që ka marrë Komiteti Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve më 5 shkurt 2014, për shpalljen e emergjencës mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë, së bashku me marrjen e masave të nevojshme për rehabilitimin e cilësisë së mjedisit. Një vendim, i cili, edhe gjatë hetimit në komisionin hetimor parlamentar na rezultoi që të jetë pasuar nga vendime të ngjashme nga këshillat bashkiakë të disa qyteteve, jo rastësisht bëhet fjalë për qytete kryesore, të njohura për nivelin e lartë të ndotjes si: Elbasani, Tirana, Fieri dhe Durrësi. U lakua ky vendim i këtij komiteti, duke thënë se cila ishte forca madhore që e detyroi këtë komitet të merrte këtë vendim. Në fakt, forca madhore nuk

është një gjë abstrakte, forca madhore është një gjë që ndihet, shihet, ishte situata që unë përshkrova pak më sipër që ne trashëguam në vitin 2013, një situatë skandaloze, e cila pa dyshim kërkonte alertin dhe vëmendjen e dikujt. Pra, implementimi i strategjive ose masave të reja për menaxhimin e mbetjeve urbane nuk nisi nga hiçi, por pati një kontekst të caktuar gjërash, të cilat përcaktuan ndërveprimin e institucioneve shtetërore me njëri-tjetrin. Në fushën e menaxhimit të mbetjeve, aktualisht, sot që flasim, është mirë ta dijë publiku, por edhe ju, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme, nga të cilat vlen të veçohet se bashkitë janë të fuqizuara në drejtim të kompetencave që kanë për administrimin e territorit dhe për menaxhimin e mbetjeve urbane, që krijohen në secilin prej këtyre territoreve. Janë bërë përgatitje nga Ministria e Mjedisit për ofrimin e një metodologjie për llogaritjen e kostos së shërbimit, që do të ndikojë në përmirësimin e tarifave për ofrimin e një shërbimi cilësor për menaxhimin e mbetjeve. Po kështu është vënë në dispozicion metodologjia për ngritjen e një databaze të unifikuar, me të dhëna të sakta të mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të çdo bashkie.

Siç do ta shikojmë edhe më poshtë, gjatë raportit, edhe një pjesë e të dhënave jo ka çaluar, por ka munguar totalisht dhe këtë na e bën me dije INSTAT-i, që është një institucion i pavarur, që nuk ka lidhje me politikën. Është miratuar Strategjia e re për Trajtimin dhe Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, që ka filluar prej vitit 2020 deri në vitin 2035. Investimet përmes financimeve nga buxheti i shtetit dhe donatorët e ndryshëm për ngritjen e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve sipas standardeve kanë filluar me ndërtimin e landfillit sanitar të Bajkajt, që mbulon Vlorën jugore, landfillit sanitar të Maliqit, që mbulon zonën e mbetjeve të Korçës, të impiantit të Elbasanit, që mbulon zonën e mbetjeve të Elbasanit, të Fierit dhe të Tiranës, që mbulon zonën Tiranë-Durrës. Këto impiante do të bëjnë të mundur jo vetëm trajtimin dhe shndërrimin e mbetjeve të ngurta nëpërmjet incenerimit, por do të bëjnë të mundur edhe përfitimin e energjisë elektrike nëpërmjet tyre.

Financimet e kryera për mbylljen apo rehabilitimin e dhjetë venddepozitimeve ekzistuese jashtë çdo lloj standardi janë një fakt i njohur; është mbyllur Porto-Romano, që ishte një vulë turpi për Shqipërinë dhe për Durrësin, por ishte një vulë turpi edhe për qeverisjen tuaj. Sot Porto-Romano është shndërruar në një ekopark dhe shpresoj në vijim, jo në ditën e përirimit, të keni mundësi të shkoni atje, siç keni shkuar, kudo tjetër ku është investuar, por që ju më parë e keni anatemuar. Janë rehabilituar venddepozitimet në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Çorovodë dhe Gjirokastër. A ka edhe bashki të tjera, ku po planifikohet të ndërhyhet për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të tyre? Po, ka edhe bashki të vogla dhe është rasti ta dinë të gjithë përfaqësuesit e bashkive të vogla, si Bashkia e Këlcyrës, Bashkia e Përrenjasit, Bashkia e Burrelit, Bashkia e Kukësit, Bashkia e Libohovës, Bashkia e Përmetit dhe Bashkia e Krujës. Investimi për ndërtimin e landfillit në Vlorë, që do të mbulojë Vlorën dhe Selenicën, është po ashtu një investim i rëndësishëm. Sidoqoftë, të vijmë te ndërtimi i impianteve, sepse kuptohet nga fjala që venddepozitime apo landfille dhe impiante nuk janë e njëjta gjë, është diçka më komplekse impianti, sepse integron brenda vetes disa procese.

Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve filloi në kushtet e një konteksti të caktuar, kur venddepozitimet ekzistuese kishin mbaruar de jure dhe de facto funksionalitetin e tyre. Ky ka qenë pikërisht momenti që ka detyruar Komitetin për Menaxhimin e Mbetjeve të shpallte emergjencën mjedisore në territor, por, njëkohësisht, i ka bërë edhe këshillat bashkiakë të qyteteve, që përmenda, të vihen në të njëjtat pozita. Ky fakt, sigurisht, nuk mund të lihet jashtë vëmendjes. Edhe në komisionin

hetimor ne u përpoqëm, nëpërmjet administrimit të dokumenteve dhe pyetjes së dëshmitarëve, ta sqaronim në mënyrë të hollësishme. Ish-fushat e mbetjeve në bashkitë Elbasan, Fier dhe Tiranë kishin dalë jashtë funksionimit, sepse ishin ngritur 25 vjet më parë, si Sharra, apo që në kohën e regjimit ish-komunist në vitet '70- të. Mjafton të vëmë në vëmendjen e secilit vetëm këtë afat kohor për të kuptuar qartësisht se në çfarë alerti mjedisor gjendeshim në shtator të vitit 2013 kur morëm qeverisjen e vendit, por edhe më tej në vitet 2014-2015, një situatë, e cila me të drejtë në dokumente të ndryshme, në pamjet filmike dhe fotografike, qoftë ato të bëra nga mediet, qoftë edhe ato që u përcollën në komisionin hetimor, përshkruanin një katastrofë të vërtetë mjedisore, veçanërisht në bashkitë Elbasan dhe Fier, të cilat njihen edhe për të kaluarën e tyre industriale, edhe për pasojat e rënda mjedisore që kjo e kaluar solli në territoret e tyre, sidomos në periudhën posttransitore të qeverisjes kur vendi ndryshoi sistemin politik.

Hetimi parlamentar lidhur me procedurat e ndërtimit dhe vënies në funksion të impianteve të trajtimit të mbetjeve për sa u takon përfaqësuesve të maxhorancës në këtë komision, siç e thashë, duhej të ngelej i ndarë nga hetimi penal dhe ka një arsye pse. Arsyeja është Kushtetuta, ligji që ne përbetohemi se e respektojmë, e zbatojmë dhe e promovojmë. Kushtetuta në nenin 7 të saj thotë se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve. E vërteta është se ky parim u shkel që në krye të herës nga kërkuesit e komisionit, të cilët në çdo qëndrim verbal dhe në çdo dokument parlamentar të përpiluar nga ana e tyre ngritën akuza penale, shpallën akuza penale dhe fajtorë, si dhe kërkuan të ushtrojnë ndikim në organin e ndjekjes penale, të cilit ligji themeltar i Republikës së Shqipërisë, në nenin 148, në paragrafët 1 dhe 2, jep ekskluzivitetin jo vetëm në ngritjen e akuzës, por edhe pavarësinë në ushtrimin e pushtetit. Ja pse përfaqësuesit politikë janë të ndaluar të shkojnë dhe të bëjnë takime me krerët e prokurorive.

Në neniN 148/1/2 të Kushtetutës thuhet: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. 2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit”. Mosrespektimi, sa më lart, nuk ishte diçka pa pasojë, mosrespektimi sa më lart ka sjellë shkelje të rëndësishme në përmbajtje, ka sjellë shkelje të rëndësishme në procedurën e punës që ndoqi komisioni hetimor parlamentar, të cilat u reflektuan hapur në mënyrën se si u drejtuan dhe u zhvilluan mbledhjet, në kërkesat për mbledhjen e informacionit, në mënyrën se si u pyetën dëshmitarët, një mënyrë tërësisht e papranueshme për sjelljen që duhet të kenë përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë dhe, natyrisht, në përfundimet e kërkuesve.

Qëllimi i çdo hetimi parlamentar është të hetojë sjelljen e subjekteve shtetërore apo publike në raport me ligjin dhe detyrën, duke u kujdesur të identifikojë mangësi të ligjit apo vakuume të parashikimeve të duhura ligjore. Këtë detyrë ka Kuvendi, sepse Kuvendi është mbajtës i pushtetit legjislativ. Ai ka detyrë të orientojë, ka detyrë të sanksionojë, ka detyrë të detyrojë nëpërmjet instrumentit ligjor, sjelljen e përshtatshme, rregullimin e duhur të fushave të veprimtarisë shoqërore, ekonomike, po të doni edhe politike. Është detyrë e Kuvendit që në një rast eventual, jo domosdoshmërisht me këtë për të cilin jemi duke folur, të paraqesë dhe ato mjete që kufizojnë pushtetin e bartësve të pushtetit ekzekutiv. Sjellja e subjekteve private, qofshin këta persona juridikë apo fizikë, në raport me ligjin, nuk mund dhe nuk duhet të jetë objekt i hetimit parlamentar, në kuptimin e ngritjes së akuzave penale nga ana e

parlamentit, sepse kjo nuk është as në tagrin dhe as në interesin publik të veprimtarisë parlamentare. Janë përmendur me dhjetëra emra personash privatë, personash fizikë, personash juridikë që unë nuk e di çfarë i thonë këto publikut, por më shumë se çfarë i thonë këto parlamentit. Sidoqoftë, në këtë raport, pavarësisht qasjes sonë sesi duhej të funksiononte ky hetim parlamentar, në respekt të detyrës që na dha Kuvendi i Shqipërisë për të mbledhur fakte të rëndësishme, gjithmonë për interesin publik të një çështjeje të rëndësishme, ne do të analizojmë në këtë raport dhe këtë kemi bërë veçmas secilën prej praktikave dokumentare që i përkasin secilit prej impianteve të trajtimit të mbetjeve.

Dua t'ju ftoj të dëgjoni disa të dhëna kryesore të kontratës së Elbasanit. Autoritet kontraktues në të tria rastet ka qenë Ministria e Mjedisit. Koncesionari në Elbasan ka qenë kompania "Albtech Energy". Forma e koncesionit është ajo që njihet anglisht si forma "BOT", por në shqip është "ndërtimoperim-transferim", që do të thotë: koncesionari ndërton, operon dhe në fund të afatit të kontratës prona, asetit, i kalon subjektit publik, bashkive. Data e lidhjes së kontratës është 16.12.2014. Periudha e koncesionit është 7 vjet. I përmend këto, sepse jo pak herë është abuzuar, duke thënë se kontratat kanë dalë jashtë afatit, janë jashtë afatit, janë bërë pagesat, ndërkohë që mjafton një verifikim i thjeshtë i afatit për të kuptuar që kontrata koncesionare e Elbasanit ka përfunduar në afat, e Fierit është në afat dhe e Tiranës është në afat. Vlera e kontratës së Elbasanit është 21 milionë e 600 mijë euro. Vendndodhja, sipas kontratës së impiantit, do të ishte në juglindje të ish-Kombinatit Metalurgjik Elbasan, në vendin e hedhjes së mbeturinave të këtij kombinati, 33 kilometra nga Tirana.

Unë besoj, nëse dikush do t'i pyeste qytetarët shqiptarë se cili qytet në Shqipëri është më i ndotur, pa dyshim që ata do të referonin të parin Elbasanin, sepse ky është, në fakt, perceptimi i përgjithshëm publik për shkak së të kaluarës së këtij qyteti, një e kaluar shumë e rënduar industriale, e cila pa dyshim që e ka ndikuar në një mënyrë ndryshe, mbase edhe më shumë se çdo qytet tjetër, cilësinë e ajrit dhe mjedisit në këtë qytet. Megjithatë, për të kujtuar edhe një herë se sa të vëmendshëm ishin ish-zyrtarët e qeverisjes së PD-së në lidhje me mjedisin. Në vitet 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 për Agjencinë Rajonale të Mjedisit të qarkut Elbasan, që drejtohej nga zyrtarë të Partisë Demokratike, sipas një raporti të saj të datës 17/09/2012, të cilin ne e kemi administruar si provë në Komisionin Hetimor Parlamentar, situata nuk është se paraqitej në këtë mënyrë, por thuhej: "ka përmirësime të dukshme", "në vitin 2009 ky përmirësim është i dukshëm, megjithatë si në të gjithë qytetet e tjera, problem ngelej pluhuri". Në vitin 2009, cilësia e ujërave nëntokësore plotëson normat e lejuara për ujë të pijshëm, ndërsa cilësia e ujërave të lumit Shkumbin është mesatare. Në vitin 2009 dhe viti 2010 ajri rezulton i pastër. Viti 2011, meqenëse materiali i plotë nuk ishte botuar akoma, duhet thënë se edhe për 2011, sipas Agjencisë Rajonale të Mjedisit në Elbasan, situata paraqitet e njëjtë. Nuk e di, por a vërejti dikush ndonjë lloj alerti? Besoj se ju duk më se normale. Kështu ishte situata për zyrtarët e qeverisjes së Partisë Demokratike, të cilët sot ankohen përse u bënë impiante. Kushdo që vjen nga Elbasani dhe cilido qytetar në Shqipëri e di shumë mirë se situata nuk ishte kaq rozë, po përkundrazi, situata ishte shumë e rënduar, sikundër ishte dhe në Fier, sepse edhe Fieri trashëgoi një histori të një ish-industrie, që sigurisht edhe ajo e ka dëmtuar cilësinë e ajrit e të mjedisit në atë qytet.

Ndërkohë, Këshilli i Ministrave, në kohën e qeverisjes së Partisë Demokratike, detyrën e vet në letra e pati bërë, por jo në terren. E kishte miratuar strategjinë me vendimin nr .175, datë 19. 01. 2011, kish bërë një përshkrim të situatës mjedisore e të menaxhimit të mbetjes, si nga pikëpamja e infrastrukturës

ligjore, ashtu edhe nga pikëpamja e menaxhimit dhe administrimit të mbetjeve, duke përcaktuar edhe hapat që duhej të merreshin deri në vitin 2025, por në fakt asnjë nga këto hapa nuk u ndërmor. Ndërkohë, raport-progresi i vitit 2009 për Shqipërinë nuk ishte aspak pozitiv, administrimi i mbetjeve shihej si shumë i dobët. Me sa dukej, strategjia ishte bërë thjesht për të justifikuar marrjen e statusit të vendit kandidat dhe vendit anëtar të Bashkimit Europian. Vërtet që qeveria angazhohej për një program të përmirësimit të mjedisit, si pjesë e një agjende më të madhe politike, siç ishte ajo për fitimin e anëtarësisë, por në fakt nuk rezultoi të ketë bërë ndonjë përpjekje për zbatimin konkret të kësaj strategjie që miratoi vetë. Ndërkohë, thamë se në shtator të vitit 2013 erdhi në pushtet qeverisja e majtë, ndodhi shpallja e emergjencës mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Bashkia e Elbasanit ka qenë bashkia e parë që ka reaguar. Më 4 korrik 2014 bashkia e Elbasanit i ka dërguar një shkresë Ministrisë së Mjedisit, përmes së cilës ka ngritur shqetësimin se “grumbullimi dhe sistemimi i mbetjeve urbane është një problem shumë shqetësues për Elbasanin, ndaj duhej marrë një zgjidhje e shpejtë në lidhje me këtë problem”.

Në të gjithë dokumentacionin që ne kemi marrë nga bashkia e Elbasanit, përfshirë këtu edhe procesverbale të diskutimit në mbledhje nga ana e anëtarëve të këshillit të bashkisë Elbasan, ku kuptohet qartësisht se kanë qenë të majtë e të djathtë; shohim të përsëritet gjithmonë e njëjta kërkesë e anëtarëve: një lutje drejtuar kryetarit të bashkisë së Elbasanit, që ai t’i drejtohej Kryeministrit, t’i drejtohej çdo ministri, që të gjente një zgjidhje për Elbasanin në lidhje me trajtimin e mbetjeve. Kërkesa që Bashkia e Elbasanit i bëri Ministrisë së Mjedisit mori një përgjigje, në të cilën, natyrisht, thuhet se përgjigjja juaj miratohet, ndaj ftohet Bashkia e Elbasanit që të paraqesë të dhëna të detajuara, vlerësime për fizibilitetin teknik, ekonomik, financiar, vlerësim të ndikimit në mjedis. Këshilli bashkiak i Elbasanit në datën 18 shtator 2014 ka vendosur që të shpallë emergjencën mjedisore, nisur nga fakti se fusha, në të cilën trajtoheshin mbetjet e Elbasanit, ishte një fushë shumëvjeçare prej disa dekadash. Në këtë pikë ne na duhet të pohojmë edhe diçka, që unë besoj se u pranua në komisionin hetimor parlamentar, që vijimisht nuk kemi punuar në drejtim të kapaciteteve, atyre kapaciteteve profesionale teknike, që kanë qaç të çmuara kur është fjala për mënyrën se si duhet ta bëjmë dhe ta trajtojmë menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Sidoqoftë, le të kthehemi te hetimi. Autoritet kontraktor, në rastet e tri kontratave koncesionare, ka qenë Ministria e Mjedisit, dhe ka një bazë ligjore për këtë, që është ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili në nenin 65 të tij thotë “Nxitja e investimeve private dhe e partneritetit publikprivat”: “Këshilli i Ministrave nxit angazhimin e sektorit privat dhe partneritetin publik-privat në veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve; projektet që në gjykimin e ministrisë synojnë të realizojnë masat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve jepen me koncesion, në përputhje me ligjin përkatës “Për koncesionet”, ligj i vitit 2006.” E referova këtë nen të këtij ligji, sepse ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” daton në vitin 2011. Ky ligj, siç është propozuar, ka qenë në fuqi edhe në kohën e qeverisjes tuaj; pra gjetëm se është zbatuar i njëjti ligj. Kjo është arsyeja pse projektet kanë qenë koncesionare dhe përse Ministria e Mjedisit, ministri i Mjedisit u angazhua në përfshirjen e sektorit privat në lidhje me trajtimin e kësaj çështjeve, sepse këtë detyrim dhe këtë të drejtë ia njihte ligji i vitit 2011. Po kështu, edhe vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit” përcaktonte qartësisht përgjegjësinë e ministrit të Mjedisit për këtë

fushë. Unë ju ftoj ta lexoni VKM-në. VKM-ja mban numrin 945, datë 09.10.2013. Pra, nuk ka asnjë dyshim që ministri i Mjedisit kishte dhe ka përgjegjësinë që të angazhohet në çështjet e mjedisit. Në këtë pjesë të raportit, ku trajtohet procedura e Elbasanit, ne nuk do të kemi asnjë koment në lidhje me procedurën, thjesht e vetëm për hir të faktit se kjo procedurë është nën hetim nga ana e prokurorisë, sepse kërkojmë ta respektojmë çuarjen deri në fund të hetimeve, që duhet të kryhen në mënyrë të plotë e të gjithanshme, por, mbi të gjitha, në mënyrë të pavarur.

Njëkohësisht, duam të konfirmojmë edhe një herë qëndrimin tonë që nuk ka pasur lëkundje në asnjë moment të vetëm, faktin që ne nuk i japim mbrojtje askujt në lidhje me akuzat penale. Ne nuk bëjmë avokatinë e askujt që është i ekspozuar ndaj një akuze penale, por pa dyshim që kemi detyrë si parlamentarë, jo si përfaqësues të kësaj apo asaj force politike, që të bëjmë diferencën midis asaj që është përgjegjësi individuale dhe asaj që është përgjegjësi kolektive, të cilat nuk mund të bashkohen asnjëherë në një gjë të vetme, sepse s'janë kurrë një gjë e vetme. Përgjegjësia penale është individuale, ndaj këdo që nuk ka pasur rastin ta shohë legjislacionin penal, e ftoj ta shohë, që të kuptojë se nëpërmjet një sërë dispozitash ligjore, del krejtësisht e qartë se përgjegjësia penale është individuale: Neni 1 "Ligji penal dhe ndarja e veprave penale"; neni 2 "Mosdënimi pa ligj"; neni 3 "Veprimi në kohë i ligjit penal"; nenet 6 deri në 11 "Për zbatimin e ligjit penal"; neni 12 "Moshja për përgjegjësi penale". A nuk i referohet kjo individit? Kuptimi drejt dhe si duhet i këtyre dispozitave mund të mos jetë i dobishëm për të gjithë, por jo për ligjvënësit, por aq më tepër për ligjvënësit e angazhuar në një komision hetimor parlamentar. Sigurisht, kuptimi i drejtë i këtyre dispozitave vlen për një jurist, por duhet të vlejë edhe për një ligjvënës, pasi çdo ligjvënës e ka për detyrë, që, në respekt të vetes dhe të detyrës që i është besuar, që të fitojë një kulturë juridike minimale, në bazë të së cilës të qëndrojë respekti, përpjekja e sinqertë dhe detyrimi për ta lexuar ligjin ashtu siç është shkruar dhe jo me syzet që të vë partia.

Po ashtu, presupozohet që institucionet duhet të sillen në bazë të ligjit e, nëse nuk rezulton kështu, sigurisht që ne kemi detyrën ta identifikojmë këtë dhe të kërkojmë vënien e tyre para përgjegjësisë. Si janë sjellë institucionet publike në Elbasan, kryetari i Bashkisë së Elbasanit, këshilli bashkiak i Elbasanit, prefekti i qarkut të Elbasanit? Sigurisht që kanë qenë shumë të shqetësuar të gjithë së bashku në lidhje me situatën mjedisore në Elbasan. Në rastin e hetimit parlamentar nuk u soll dot asnjë provë, asnjë e dhënë që të mund të provonte të kundërtën. E kundërta, sipas logjikës së opozitës, do të duhej të ishte: të gjithë këta njerëz kanë bërë sikur ishin të shqetësuar. Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", por edhe ai "Për trajtimin e mbetjeve" i japin përgjegjësi të plotë pushtetit lokal për t'u angazhuar në vetë të parë, për t'u dhënë qytetarëve shërbimin e pastrimit e trajtimit të mbetjeve. Në kontekstin e detyrimeve që shpjegojmë, po ashtu Ministria e Mjedisit ka rol kryesor dhe patjetër që ajo vazhdon ta ruajë këtë përgjegjësi sipas ligjit. Ndërkohë që Bashkia e Elbasanit u vu në kontakt me Ministrinë e Mjedisit për problemin e saj, çfarë ndodhi me Këshillin e Ministrave; si u investua Këshilli i Ministrave; çfarë bënë ministrat e fushave të ndryshme, të cilët kuptohet qartësisht se nuk e kanë përgjegjësinë e tyre funksionale ose, më mirë të them, nuk e kanë rol ose atribut kryesor zgjidhjen e çështjes mjedisore? Në datën 31 tetor 2014 Ministria e Mjedisit, referuar ligjit për koncesionet, i është drejtuar ministrit të Financave lidhur me koncesionin e Elbasanit, i cili, natyrisht, ka një përgjegjësi të caktuar që ia parashikon ligji për koncesionet.

Unë po lexoj nenin 42, i cili thotë se projekti, që ka nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave në lidhje me përballueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, domethënë ndikimet dhe risqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente. Në të njëjtën datë i është dërguar informacion edhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pra studimi teknik dhe përshkrimi financiar, me qëllim që edhe kjo ministri të mund të njihte teknologjinë e ofruar, duke iu referuar gjithmonë fushës së saj të përgjegjësisë. Sidoqoftë, ligji për koncesionet dhe PPP-të përcakton që Ministria e Financave jep miratimin paraprak për studimin e fizibilitetit të dërguar nga autoriteti kontraktues. Siç thamë edhe një herë, roli i Ministrisë së Financave kufizohet në dhënien e miratimit paraprak për tri aspekte, përballueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, e parë kjo nga pikëpamja e buxhetit të shtetit. Pra, siç u shpjegua edhe në komisionin hetimor nga ish-ministri i Financave, zoti Cani, nga ish-ministri i Financave, zoti Ahmetaj, roli i Ministrisë së Financave në rastin e dhënies ose jo miratim për procedurat koncesionare, jemi duke folur për Elbasanin, është i përcaktuar dhe i përshkruar qartësisht në ligjin për koncesionet, ose ligjin për PPP-të dhe roli i kësaj ministrie përcaktohet pikërisht në vlerësimin e këtyre tri elementeve që thamë. Të njëjtën gjë Ministrisë së Financave ia detyron edhe VKM-ja nr. 575 e vitit 2013, neni 8 i saj, në të cilin thuhet se, nëse krahasimi mes alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesionit tregon se zgjidhja e dytë ka potencial të ofrojë vlerën më të mirë të pasur autoriteti kontraktues mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion.

Projekti, i cili përmbush kushtet që përcaktohen në ligj dhe në VKM-në përkatëse, paraqitet për miratim të Ministria e Financave dhe është pikërisht kjo ministri që e vlerëson projektin. Sigurisht, gjërat nuk kanë ndodhur në një ditë. Shkoi një kërkesë nga Ministria e Mjedisit të Financat dhe Ministria e Zhvillimit, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Ekonomisë dhe përgjigjet u dhanë po atë ditë ose të nesërmen. Ka pasur një komunikim shkresor të shkrirë në disa muaj, ku ministritë janë dhënë dhe kanë marrë me njëratjetrën, kanë rakorduar sugjerimet dhe vërejtjet përkatëse për të ardhur në momentin final. Ky komunikim i zgjatur na rezulton nga shkresat e datave 18 nëntor, 20 nëntor deri në dhjetor, një komunikim i cili i referohet vetëm shkëmbimit shkresor midis autoritetit kontraktues dhe Ministrisë së Financave. Në komisionin hetimor nga pyetjet dhe nga përgjigjet e dhëna nga dëshmitarë të ndryshëm, që ishin pjesë e seancave dëgjimore, u evidentua që një nga vendimet, që ka marrë më shumë diskutim, ka qenë pikërisht vendimi nr. 907, datë 17.12.2014, i Këshillit të Ministrave për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve në qarkun e Elbasanit dhe prodhimin e energjisë. Në fakt, ky është vendimi i vetëm që ka dhënë Këshilli i Ministrave, ku ministri i Financave, që kishte përgjegjësinë sipas ligjit, dha miratimin nga ana e tij për ato aspekte që thamë, të cilat lidheshin me studimin e fizibilitetit. Vendimi i mësipërm ka si bazë ligjore nenet 27 dhe 41 të ligjit për koncesionet. Këto dy nene përbëjnë edhe autorizimin ligjor për nxjerrjen e VKM-së. Pse i themi këto gjëra që duken edhe kaq teknike? Sepse është akuzuar i gjithë Këshilli i Ministrave për përfshirje në një vepër penale.

I gjithë Këshilli i Ministrave është etiketuar si një grup i strukturuar kriminal, që ka vepruar si një grup i strukturuar kriminal, që është krijuar enkas për të vepruar si një grup i strukturuar kriminal, ndërkohë që projektet nisin të hartohen nga administrata e institucioneve të veçanta qendrore, plotësohen rrugës



me sugjerimet dhe vërejtjet e njëri-tjetrit për të ardhur në momentin e duhur, në momentin kur ato duhet të përfshihen në rendin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave dhe të miratohen nga Këshilli i Ministrave. Bazuar në nenin 9 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, edhe ky një ligj i vitit 2003, me të cilin ka vepruar qeverisja juaj mbi atë ligj, vepron edhe qeverisja jonë, përcaktohen kompetencat e sekretarit të Përgjithshëm, meqenëse është hallka e cila siguron që çdo akt, i cili propozohet për t’u miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, të ketë setin e të gjithë dokumentacionit që parashikon ligji në mënyrë bashkëshoqëruese, me qëllim që të mund të realizohet dhënia e miratimit.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes së Këshillit të Ministrave drejtuesi i mbledhjes, Kryeministri ose zëvendëskryeministri i fton të gjithë anëtarët që të shprehen duke dhënë mendimin e tyre në lidhje me aktin e marrë. Pas shfaqjes së mendimit, të gjithë anëtarët votojnë, dhe votimi në Këshillin e Ministrave është një votim i hapur, i cili realizohet me shumicën e votave të të pranishmëve; kjo është sqaruar nga zoti Agaçi në dëshminë e tij në komisionin hetimor, është e sqaruar saktësisht edhe në përmbajtjen e ligjit 2003. Ndërkohë që dhënia e miratimit të financimit të të kontratës koncesionare të Elbasanit ka qenë një vendim që është marrë me unanimitetin e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe kujtojmë që në vitet 2013, 2014, 2015, 2016 PS-ja nuk qeveriste e vetme në pushtet. Sikurse përmendëm, procedurat koncesionare janë kompetencë e autoritetit kontraktor. Në zbatim të përgjegjësive të veta, autoriteti kontraktor ka vijuar me ngritjen e komisionit për vlerësimin e ofertave dhe ka vazhduar me lidhjen e kontratës. Kontrata është lidhur në datën 16.12.2014. Projektvendimi që ne thamë se për muaj e muaj me radhë u bë refren nga PD-ja dhe opozita, anëtarët e saj në komisionin hetimor, sikur Këshilli i Ministrave kishte miratuar një akt të paligjshëm, pasi Agjencia e Prokurimit Publik kishte kthyer një përgjigje negative, por kjo u hodh poshtë nga dokumentacioni i administruar në komisionin hetimor dhe nga dëshmitë, unë po i veçoj dëshmitë, sepse keni rast t’i lexoni e t’i gjeni të zbardhura në faqen e Kuvendit, të zotit Cani, të zotit Ahmentaj, të zotit Agaçi, të zonjës Kashta, të cilët provuan që Këshilli i Ministrave ka miratuar vetëm një vendim për Elbasanin, atë për dhënien e miratimit të financimit të kontratës dhe nuk ka miratuar asnjë lloj vendimi tjetër, që kishte të bënte me procedurën e ndjekur për lidhjen e kësaj kontrate.

Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar kontratë për dhënien e koncesionit. Këtë kontratë e ka lidhur ministri i Mjedisit dhe koncesionari, shoqëria “Albtech sh.p.k”. Procedura e negocimit të kontratës ka qenë ajo e negocimit pa shpallje paraprake. A ka ndonjë ligj që njeh një procedurë të tillë? Po, patjetër që ka një ligj që njeh një procedurë të tillë, është ligji nr. 9643 i prokurimit publik i vitit 2016. Ky ligj në përmbajtje të tij njeh procedurën e negocimit pa shpallje paraprake. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 907 “Për dhënien e miratimit të financimit për kontratën e Elbasanit” është dhënë në datën 17.12.2014. Këtu dua të tërheq vëmendjen e të gjithëve, sepse është një datë, për të cilën është prodhuar një lajm në mënyrë skandaloze i rremë, është thënë që në këtë datë nga qeveria janë marrë 17 vendime për procedurën e Elbasanit. Jo vetëm që nuk është e vërtetë, është miratuar vetëm 1 vendim për procedurën e Elbasanit, është vendimi nr. 907, që është miratuar në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje, një mbledhje jo e jashtëzakonshme, sikurse ka pretenduar opozita, një mbledhje e zakonshme e Këshillit të Ministrave, ku janë miratuar 20 akte të ndryshme, por vetëm njëri ishte akti që kishte të bënte me kontratën koncesionare për trajtimin e mbetjeve në Elbasan. Kjo ishte e pavërteta e radhës, me të cilën

e anëtarët e opozitës në komisionin hetimor parlamentar u përballën dhe, sigurisht, nuk kishin më komente të tjera për të bërë.

Kujtoj edhe një herë se ka qenë dhe mbetet në traditën e Këshillit të Ministrave që ky i fundit të mbledhet ditëve të mërkura dhe data 17.12.2014 ka qenë një ditë e zakonshme, ku janë propozuar për t'u miratuar 20 akte, një nga këto ishte projektakti që kishte të bënte me dhënien e financimit për kontratën e Elbasanit. Nuk janë 17 vendime të miratuara në një ditë, në një ditë të jashtëzakonshme, në një mbledhje të jashtëzakonshme dhe vetëm për procedurën e Elbasanit. Po kështu, është rasti të kemi në vëmendje se vendimmarrja e Këshillit të Ministrave është një vendimmarrje, e cila realizohet duke ndjekur një procedurë paraprake që në praktikë nuk zhvillohet thjesht nëpërmjet letërkëmbimit postar, por është një vendimmarrje që realizohet nëpërmjet sistemit "e-Akte", që është një sistem i implementuar që në vitin 2010, të cilin sigurisht që qeveria e përdor, sepse është më efikas, më eficient për vendimmarrjen. E kemi gjetur, e kemi përmirësuar, vazhdojmë ta përdorim dhe do ta përdorim këtë sistem, prandaj nuk është ndonjë habie e madhe që në botën digjitale përgjigjet të merren më shpejt sesa në rrugën që krijon shërbimi postar i dekadave më parë.

Meqenëse autoriteti kontraktor, Ministria e Mjedisit kishte përfshitë dhe kishte garantuar që kostot përkatëse të këtij projekti ishin të planifikuara dhe përballoheshin brenda buxhetit vjetor të Ministrisë së Mjedisit, të miratuar nga Kuvendi brenda tavanëve të shpenzimeve për periudhën afatmesme të miratuar nga Këshilli i Ministrave, pas dhënies së miratimit paraprak nga Ministria e Financave, sikundër rezultoi gjatë marrjes së dëshmisë së zotit Cani, në lidhje me qëndrueshmërinë, përballueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, është vijuar me miratimin e kontratës. Për zbatimin e kontratës koncesionare të Elbasanit nuk janë bërë vetëm këto veprime, por ka pasur edhe veprime të tjera. Unë dua të veçoj procedurën për nxjerrjen e lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Ministria e Mjedisit më 14 janar 2015 i ka dërguar shkresë Agjencisë së Planifikimit të Territorit për çështjen e lejes së ndërtimit, leja është dhënë vërtet në datën 27 janar, por është zbardhur në mars të vitit 2015. Këtë provë, që duket minimaliste, e sjellim në vëmendjen e të gjithëve, sepse diferenca kohore e evidentuar në më shumë se një rast tregon qartësisht se nuk ka pasur asnjë lloj sjelljeje të paracaktuar enkas apo dukshëm në favor të koncesionarit nga ana e institucioneve qendrore, ministrive, autoriteteve të tyre të varësisë, të tilla që këto i paskan shërbyer vendimmarrjes së një grupi të organizuar dhe të interesuar për të marrë një vendim të përbashkët në favor të një të treti! Përkundrazi, sjellja e institucioneve ka qenë konform ligjit dhe përgjegjësive përkatëse, institucionet i janë përgjigjur emergjencës mjedisore në një qark si Elbasani, për të cilin ekzistonte, dhe ndoshta vijon të ekzistojë falë edhe gënjeshtrove tuaja, perceptimi publik se ka një situatë të rëndë mjedisore.

Konform ligjit u provua të ketë qenë edhe vendimmarrje tjetër e Këshillit të Ministrave, ajo që i referohet VKM-së nr. 822/2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni". Roli i Ministrisë së Energjetikës përcaktohet nga legjislacioni, që referon te kjo ministri, është ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike". Janë disa nene të këtij ligji, të cilat po i citoj vetëm si numër nenesh për të evituar leximin e ligjit që e kanë përpara të gjithë; kam përpara nenin 49 të ligjit "Ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese", në të cilin thuhet: "Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, që nuk janë objekt koncesioni ose çdo kapacitet i ri prodhues deri në 2 megavat, miratohet nga ministri përgjegjës për

Energjinë. Ndërtimi i kapaciteteve prodhuese mbi 2 megavat, që nuk janë objekt koncesioni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë”.

Vazhdon më tej: investimi i Këshillit të Ministrave nuk ndodh rastësisht, por ndodh pikërisht prej propozimit të ministrit të Energjisë, i cili miraton rregullat dhe procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese mbi baza transparente dhe jo diskriminuese, sikundër referon ligji më poshtë. Këshilli i Ministrave është ftuar të marrë vendim mbi bazën e propozimit të ministrit të Energjisë. Ministri i Energjisë nga ana e tij ka pasur një vendimmarrje duke iu referuar ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, që është ligji i tij organik. Kjo vendimmarrje, e cila për Ministrinë e Financave rezultoi realizuar me shkresën e prot nr. 4557/7, datë 31.10.2016, i referohet vendimmarrjes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impianti me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit nga shoqëria “Albtech Energy”. Ky vendim, siç e thamë, është dhënë si pasojë e detyrimit të ligjit dhe nuk ka pikë lidhje me akuzën se kjo shkresë në vetvete përbëka një koncesion të fshehur për 25 vjet për shitjen e energjisë! Detyrimi për pajisjen e koncesionarit me miratimin në fjalë vjen jo vetëm si detyrim i ligjit, por është detyrim i kontratës koncesionare, që kishte hyrë tashmë në fuqi më 16 dhjetor. Kjo kontratë kishte marrë fuqi ligjore, për shkak se ishte nënshkruar nga palët e asaj kontrate. Natyrisht që ministri i Energjisë, po ashtu, ishte i detyruar ta licenconte këtë burim të ri të prodhimit të energjisë. Pretendimi se kemi të bëjmë me koncesion të ri, është një absurditet apo një lajthitje ekstreme, pasi nuk ka asnjë bazë ligjore për t’u konsideruar koncesion, por, mbi të gjitha, kjo gjë nuk është vënë ndonjëherë në diskutim nga askush, qoftë edhe nga Gjykata Administrative për konfliktin që është krijuar midis koncesionarit dhe ERE-s lidhur me mosmiratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën e operimit deri në vitin 2021.

Për më tepër, edhe në letërkëmbimin që koncesionari dhe Ministria e Infrastrukturës kanë pasur rezultoi e qartë se çdo aset në përfundim të afatit dhe çdo e drejtë e zotëruar nga shoqëria koncesionare, në rastin konkret “Albtech Energy”, do t’i kalojë Bashkisë së Elbasanit pa asnjë pretendim për të. Ndjesë, sepse ka disa hollësi, por hetimi ka qenë kompleks, çështjet mbeten komplekse, shkresat e administruara kanë qenë voluminoze dhe, për t’i dhënë përgjigje çdo pretendimi, natyrshëm lind nevoja të kemi një përmbledhje të të gjitha akteve të analizuara dhe të administruara. Nëse impianti në Elbasan nuk do të ishte pajisur nga ministria me këtë autorizim, ministria vetë do të ishte në shkelje të ligjit dhe të kontratës. Mbi të gjitha, ajo do ta bënte të pamundur tregtimin e energjisë së prodhuar, duke e privuar impiantin e përpunimit të mbetjeve që, në përfundim të afatit të kontratës i kalon në pronësi Bashkisë së Elbasanit, nga një e ardhur e rëndësishme që shërben për mbulimin e kostove operative të veprës dhe jo vetëm. Pra, duhet të jemi të qartë se përfundimi i kontratës koncesionare të Elbasanit, që kishte një afat 6 vjet, shënonte edhe momentin e kalimit të të drejtave, të çdo aseti që zotëronte koncesionari te Bashkia e Elbasanit, duke përfshirë këtu të gjitha lejet dhe licencat e dhëna në funksion ose të lidhura me këtë impiant. Këtë e përcakton kontrata, por, edhe po të mos ishte kështu, është Kodi Civil, i cili përcakton qartësisht parimin që çdo gjë që lind me sendin kryesor kalon nga njëri pronar tek tjetri. Subjekti “Albtech Energy” në vetvete është një subjekt i krijuar për qëllime të veçanta, i krijuar vetëm për qëllimin e ndërtimit të impiantit të Elbasanit. Ai nuk mund të kryente aktivitet tjetër përveçse aktivitetit që kreu në Elbasan dhe në përfundim kishte vetëm një detyrim që çdo të drejtë t’ia kalonte pronaritshtet, gjë e cila në rastin konkret nuk ndodhi, por kjo nuk do të thotë se nuk do të

ndodhë. Impianti për momentin është i sekuestruar me vendim të Gjykatës së Posaçme, është marrë nën administrim prej administratorëve të caktuar nga Gjykata e Posaçme dhe shumë shpejt impianti do t'i kalojë Bashkisë së Elbasanit për ta operuar me të gjitha funksionet e veta.

Në komisionin hetimor parlamentar, por edhe në publik është thënë shumë shpesh që ky impiant nuk ka prodhuar asnjëherë energji elektrike, është thënë edhe që nuk funksionon fare, madje në fillim të hetimeve të këtij komisioni parlamentar është thënë që nuk ekzistojnë impiantet dhe se janë fantazma, por, fatmirësisht, kjo ishte dhe arsyeja pse e falënderova opozitën, duke kërkuar ngritjen e këtij komisioni hetimor; opozita nuk na e dha mundësinë thjesht neve, anëtarëve të maxhorancës, por u dha mundësi të gjithë qytetarëve të shikonin se çfarë kishte ndodhur konkretisht, që këto impiante janë ngritur, që impianti i Elbasanit ka funksionuar dhe vijon të funksionojë, ndonëse në mënyrë pjesore aktualisht, për shkak të vendimmarrjes së prokurorisë dhe të Gjykatës së Posaçme. Sidoqoftë, kjo situatë e përkohshme nuk mund të vërë në dyshim faktin që impianti në Elbasan ka prodhuar energji. Gjëja bëhet e qartë nëpërmjet shkresës që operatori i energjisë i ka dërguar komisionit hetimor parlamentar. Bëhet fjalë për shkresën e datës 23.11.2021, në të cilën thuhet: “Për inceneratorin e Elbasanit ju bëjmë me dije se shoqëria “Albtech Energy” ka aplikuar pranë OSHEE-së për lidhje të burimit gjenerues në rrjetin shpërndarës të OSHEE-së që në gusht të vitit 2016. Në prill të vitit 2017 është instaluar në objekt matësi i energjisë elektrike me dy drejtime.

Në datën 06.06.2017 shoqëria ka njoftuar OSHEE-në se do të kalojë në regjimin e dhënies së energjie elektrike në rrjetin e operatorit të shpërndarjes. Deri në datën 08.11.2021 rezultoi se ky subjekt ka injektuar në rrjetin shpërndarës sasinë e energjisë prej 6,748,2 megavatësh dhe ka përdorur për nevojat e veta 2,792,6 megavat”. Kjo e dhënë shkresore u faktua edhe nga konstatimi në vend i komisionit hetimor, i cili pa në impiantin e Elbasanit që ishin vendosur matësi dhe kabina elektrike. Sigurisht, këto nuk janë skena të lëvizshme, që vendosen në momentin kur vajti komisioni hetimor dhe më pas largohen; këto ishin punë të kryera, funksione që kishin ndodhur tanimë. Kjo, së bashku me shkresën e OSHEE-së, është një provë e fortë, që rrëzoi poshtë pretendimin se në Elbasan nuk është bërë asnjëherë incenerim gjatë kohës së operimit të kontratës koncesionare, një kontratë, që, e thamë, u lidh nga ministri i Mjedisit, sipas përgjegjësive që i jepte ligji “Për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane”. Vendimmarrja më tej e institucioneve të tjera shtetërore, përfshirë dhe Këshillin e Ministrave, ka ardhur si rezultat i zhvillimit të një procesi të iniciuar nga organi përgjegjës, por është një proces që ka finalizuar në disa produkte, që ia vlen t'i përmendësh. Sot në Elbasan 5 nga 7 bashkitë e këtij qarku i çojnë mbetjet e tyre pikërisht në këtë impiant: Bashkia e Cërrikut, Bashkia e Belshit, Bashkia e Librazhdit dhe Bashkia e Gramshit. Bashkitë e Përrenjasit dhe Peqinit ende nuk janë gati për t'i çuar mbetje te ky impiant, por të pesta bashkitë e tjera, që përmendëm, çojnë 100-104 tonë mbetje në ditë në impiantin e Elbasanit. Këto mbetje, pasi hyjnë në impiant, peshohen, seleksionohen dhe ndahen veçmas letra, kartoni, i gjithë produkti prej xhami ose qelqi, tërhiqen pjesët që janë metalike, hekuri dhe, natyrisht, pjesa e mbetjeve që konsiderohet se nuk mund të ripërdoret është pjesa e mbetjeve urbane që trajtohet me incenerim. Ku është ndërtuar impianti i trajtimit të mbetjeve në Elbasan? Është ndërtuar në një tokë publike që më parë ka qenë vendi i quajtur Dampa e Hireve, pra vendi ku depozitoheshin hiret e ish-Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Ishte pikërisht kjo ajo që shkaktonte dhe renë toksike në Elbasan.

Ky vend sot rezulton i rehabilituar totalisht. Sipërfaqja publike, që është përdorur për ngritjen e këtij impianti, i shërben edhe një herë depozitimit të 100 apo 104 tonë mbetjeve në ditë, që sillen nga 5 prej 7 bashkive që ka qarku i Elbasanit. Pra, mund të themi që në masën mbi 80% qarku i Elbasanit e ka të zgjidhur sot problemin e trajtimit të mbetjeve. Hetimi parlamentar për Elbasanin tregoi edhe një herë se opozita nuk ka asnjë qasje në provueshmërinë e akuzave për grup të strukturuar kriminal, për korrupsion të kryer në bashkëpunim nga ana e qeverisë dhe zyrtarëve lokalë për pastrim të produkteve të veprës penale. Asgjë e tillë nuk u provua dhe nuk provohet se ekziston përballë fakteve dhe të dhënave të qarta e të plota. Çdo abuzim me ligjin, që mund të kenë kryer palët kontraktuese të kontratës, nuk është në tagrin e komisionit hetimor parlamentar për ta gjykuar apo për ta konfirmuar si të vërtetë. Kjo do të jetë pjesë e detyrimeve që ka prokuroria së bashku me gjykatën. Natyrisht, kjo nuk mund të shërbejë dhe nuk mund të shndërrohet në një akuzë kolektive për Këshillin e Ministrave dhe Kryeministrin, pasi qartësisht mungojnë elementet që i ka të nevojshme një vepër penale, siç janë ana objektive dhe ajo subjektive e veprave të pretenduara. Nuk u provua në asnjë rast që të ketë lidhje midis veprimeve të institucioneve të ndryshme dhe pasojave që dyshohet të kenë ardhur, sipas hetimit të SPAK-ut, në këtë procedurë.

Veprimet e institucioneve të tjera shtetërore kanë qenë të pavarura nga njëra-tjetra; janë kryer si detyrim që u ngarkon ligji organik, mbi bazën e të cilit ato veprojnë, apo kanë qenë të lidhura me përgjegjësinë funksionale të tyre; nuk ka pasur ndonjë lloj bashkëpunimi të veçantë, që të mund të mendojmë se ka pasur një grup të strukturuar, të krijuar apo të udhëhequr posaçërisht për qëllime kriminale. Mendoni pak: një gjë që fillon që nga bashkitë, nga përfaqësuesit lokalë të të gjitha partive, vjen në nivelin qendror, në administrata e institucione të ndryshme, është e paimagjinueshme se si mund t'i marrësh të gjithë këta njerëz që kanë qenë, vijojnë të jenë e do të jenë në administratën publike dhe t'i akuzosh se janë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, kur secili ka qenë në detyrën dhe në përgjegjësinë e vet, ndërsa ka dhënë përgjigje për mënyrën se si do të realizohej procedura koncesionare e Elbasanit! As më shumë e as më pak, akuzat e opozitës në këtë drejtim janë shpifje, të cilat nga fillimi e deri në fund kanë pasur një qëllim: të dezinformojnë opinionin publik për të marrë prej tij kredo politike dhe kredo publike, në rastin kur gara e partive politike, kuptohet, duhet të bazohet në oferta prej politikash të ndershme dhe prej politikanësh që gëzojnë mbështetje dhe kanë integritet e reputacion të besueshmërisë. Po përmbledhim edhe një herë pak konkluzione për Elbasanin. Puna për këtë projekt filloi në korrik të vitit 2014 dhe mbaroi më 16 dhjetor të vitit 2014, pra janë dashur 5 muaj për të bërë impiantin e Elbasanit dhe jo një ditë, ku u morën 17 vendime. U vërtetua nga dokumentacioni dhe dëshmitë se në mbledhjen e datës 17.12.2014 është miratuar vetëm një vendim nga ana e qeverisë, që është vendimi që siguron financim për kontratën e koncesionit të Elbasanit. Është hedhur poshtë fakti se ministri Cani nuk kishte dhënë miratimin për mbështetjen financiare të impiantit të trajtimit të mbetjeve të Elbasanit. Këtë e pohon shkresa, por e pohoi me gojën e vet edhe zoti Cani, sikundër bashkë me këtë u hodh poshtë edhe arsyeja pse zoti Cani ishte larguar nga detyra, e aluduar nga opozita. Për sa u takon diskutimeve se cili ishte autoriteti kontraktues, është krejt e qartë se autoriteti kontraktues në të tria rastet ka qenë Ministria e Mjedisit dhe shoqëritë koncesionare.

Procedurat që ka ndjekur Këshilli i Ministrave për vendimmarrjen e vet, janë tërësisht të bazuara në ligj. E tillë është edhe procedura e ndjekur nga sekretari i Përgjithshëm; është një procedurë e cila gjën

mbështetje në nenet 9, 13 dhe 15 të ligjit nr. 9000 të vitit 2003. Edhe vendimmarrja e Këshillit të Ministrave për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit për rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, po ashtu, është një procedurë e mbështetur në ligj. Sikurse u sqarua edhe një herë, nuk ka një koncesion të ri në rastin që është dhënë autorizim për ndërtimin e impiantit të prodhimit të energjisë elektrike dhe lidhjes me rrjetin, sepse është e qartë që impiantet u ndërtuan me këtë synim dhe, në fund, u kalojnë bashkive. E njëjta gjë është edhe për Fierin. Pra, Fieri dhe Elbasani janë të njëjtë për sa i takon mekanizmit se si do të operohej. Projektet janë përcjellë rregullisht në Këshillin e Ministrave dhe, ky i fundit, sigurisht, në fund të ditës do të bënte një vendimmarrje, sepse nuk mund të ishte indiferent ndaj një situatë që thërriste në Elbasan. Vijmë te Fieri. Kontrata koncesionare e Fierit është realizuar më vonë, por, pak a shumë, në të njëjtin kontekst. Cilat janë të dhënat e kontratës së Fierit? Si gjithmonë, autoriteti kontraktor është Ministria e Mjedisit. Koncesionari është “Integrated Technology Waste Treatment Fier”. Forma e koncesionit është e njëjtë: ndërtimoperim- transferim Kontrata është lidhur më 24.10.2016. Periudha ishte 6 vjet. Nga këtu deduktohet qartë që nuk ka mbaruar ende afati i kontratës për Fierin, sepse po pretendohet pse nuk punon Fieri dhe pse nuk ka mbaruar kolaudimi i pajisjeve të ndryshme që i takojnë agregatit të incenerimit, madje dëgjova këtu të thuhet që kjo mbaron për 35 ditë, nuk e di nga e gjetën këtë. Do të ishte mirë nëse i referohemi asaj çka tha drejtuesi i punimeve, por përfaqësuesit e opozitës mezi erdhën, madje nuk donin të vinin fare në asnjë prej këtyre impianteve, sepse pretendonin që këto nuk ekzistonin, pretendonin që këto ishin ca “karakatina”.

Në fakt, ne u përballëm me impiante të reja, me impiante moderne, me impiante tërësisht teknologjike që kërkojnë mobilizimin e një fuqie jo të thjeshtë punëtore, sepse kërkohet të vihen në punë nëpërmjet kapaciteteve të duhura intelektuale. Për sa i takon vendit ku do të ndërtohej impianti, në këtë kontratë koncesionare nuk ka një vendndodhje reale, por në kontratë është thënë: shesh i miratuar me vendim të këshillit bashkiak. Kontrata ka vlerën prej 28 milionë eurosh, sepse impianti i Fierit është një impiant më i madh për nga kapacitetet, është një impiant që trajton edhe më shumë mbetje në raport me impiantin e Elbasanit. Përpjekja për ta ndërtuar këtë impiant ka filluar që në vitin 2015. Në këtë rast Ministrisë së Mjedisit i është paraqitur një propozim i pakërkuar. Ne e shprehëm që vetë kuadri ligjor i vitit 2011 e lejonte dhe e detyronte Ministrinë e Mjedisit t’i angazhonte privatët në çështjet e trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve. Ndërkohë që Ministria e Mjedisit fillon të investojë në mundësinë e realizimit të një projekti të tillë, edhe në Fier u shpall emergjenca mjedisore. Kjo në komisionin hetimor u provua krejtësisht. Ish-fusha e mbetjeve në Fier ishte një fushë që datonte që prej vitit 1970. Ajo fushë u bë e njohur verën e shkuar për të gjithë publikun për shkak të lartësisë së mbetjeve, që arriti deri në 6 metër, një fushë ku mbetjet hidheshin, nuk trajtoheshin dhe shpeshherë vinin edhe zjarre të qëllimshme, kjo pa dyshim ka qenë një situatë shumë e rëndë për Bashkinë e Fierit.

Në datën 27.07.2015 Këshilli Bashkiak i Fierit ka vendosur, pikërisht, për këtë problematikë, që kishte në territorin e vet. Kujtoj që viti 2015 ka qenë viti kur u bë reforma administrative territoriale dhe problemi i mbetjeve u bë edhe më evident, sepse bashkitë nuk ishin më aq të vogla, bashkitë morën brenda tyre edhe ish-komunat, për këtë arsye të gjitha mbetjet që vinin nga ish-komunat, shtu këtu edhe mbetjet që kishin vetë qytetet, sigurisht e rënduan problematikën dhe në këtë moment fushat e mbaruan funksionalitetin e tyre apo e ezauruan arsyen për të cilën ishin projektuar më herët. Këshilli bashkiak i

Fierit i ka kërkuar ekzekutivit të Bashkisë së Fierit të trajtojë një plan vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në përputhje me planin rajonal të tyre për këtë temë. Po kështu i është kërkuar Bashkisë së Fierit të negociojë, gjithmonë nga këshilli bashkiak, me subjekte shtetërore dhe private për të zgjedhur vendin se ku do të depozitoheshin mbetjet. Natyrisht i është kërkuar bashkisë të negociojë edhe me partnerë, qofshin këta edhe të huaj, për të realizuar zgjidhjen e këtij problemi. Më 26 tetor 2015 këshilli bashkiak i Fierit, me vendimin nr. 40 ka vendosur të shpallë edhe ai emergjencën mjedisore. Unë edhe një herë them se nuk ishte thjesht në vetvete vendimi i Komitetit Ndërmnistror për Menaxhimin dhe Trajtimin e Mbetjeve, por ishte pikërisht situata faktike ajo që i ka detyruar këto këshilla të marrin këto vendime. Kështu që, nuk ka asnjë vlerë diskutimi i atij dokumenti, që ka prodhuar ky komitet përpara një situatë me të cilën janë përballur të gjithë qytetarët, jo thjesht këshilltarët apo kryetarët e bashkive. Në vendimin nr. 40 është kërkuar që si venddepozitimi për mbetjet e Fierit të ishte njësi administrative Portëz.

Në fakt, gjatë gjithë kohës janë përmendur 2 venddepozitime: fshati Plyk dhe fshati Mbyet, por në të vërtetë ka qenë vetëm një venddepozitim. Ndryshimi i emrave ka ndodhur, sepse të dy fshatrat janë kufitarë dhe në momentin që është bërë saktësimi i zonës kadastrale, ku do të ndërtohej impianti, ka rezultuar që kjo zonë kadastrale nuk ishte e fshatit Plyk të njësisë Portëz, por ishte e fshatit Mbyet e njësisë Portëz. Kjo për të qenë të qartë, sepse edhe mbi këtë fakt është abuzuar shumë, ndërkohë që kryetari i bashkisë në dëshminë e tij, me dokumentet që solli, e provoi qartësisht, por edhe ne që ishim në terren e konstatuam këtë gjë. Impianti, ndonëse fillimisht u përcaktua nga këshilli bashkiak që të ndërtohej në Portëz, nuk u ndërtua në këtë njësi, dhe ka arsye pse nuk u ndërtua këtu, por u ndërtua në njësinë administrative Mbrostar. Ne e dimë, janë administruar një sërë dokumentesh, që tregojnë në mënyrë kronologjike pse u ndryshua vendi i diskutuar paraprakisht në këshillin bashkiak të Fierit. Për më tepër ka pasur edhe një hetim gjyqësor, që është konkluduar me një vendim gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata Administrative e Apelit të Tiranës, e cila, nëpërmjet përshkrimit të përfundimeve të veta, na vë në ligjëvënësve në pozitën që t'i marrin siç janë këto përshkrime, sepse këtë na e detyron ligji.

Çdo gjë që faktohet, sanksionohet me një vendim gjykate të formës së prerë, është e detyrueshme për t'u marrë dhe për t'u vlerësuar si e tillë. Në datën 24 tetor 2016 Ministria e Mjedisit i ka dërguar Bashkisë së Fierit një kopje të kontratës së koncesionit. Ndërkohë, në datën 25.10.2016 Bashkia Fier fillon procedurat e shpronësimit për interes publik për pronat private në fshatin Mbyet, sepse kjo ishte vendndodhja që ata kishin përcaktuar pak më përpara. Por ekipi i koncesionarit më 1 nëntor 2016 ose pak para kësaj date, shkon në vendin, ku pretendohej të ndërtohej impianti, konstaton, këtë ia bën me dije edhe kryetarit të Bashkisë së Fierit, edhe këshillit bashkiak Fier, se vendi në fjalë kishte disa problematika. Cilat ishin këto problematika që u ndeshën në vend? "Topografia e terrenit të përzgjedhur e bën problematike dhe mjaft joefikase procesin e kërkuar teknologjik të ndërtimit të impiantit. Largësia nga pikat e lidhjes me energji elektrike është gjithashtu një problematikë, që duhet riparë me vëmendje. Bazuar në studimet gjeologjike, pjerrësitë e terrenit dhe afërsia me lumin Gjanica, besohet se mund të ketë shkarje, të cilat do të vinin në rrezik projektin, duke ndikuar mjaft në realizimin e parametrave konstruktivë dhe duke çuar në një situatë të papëlqyeshme mjedisore, me të cilën do të ballafaqohemi në realizimin e veprës". Ndërkohë, thamë që fusha e mbetjeve në Fier ishte në gjendjen që ishte, në

gjendje skandaloze. Këtë situatë e kemi marrë të përshkruar edhe nëpërmjet një memo-je të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Publik të Bashkisë Fier.

Është një memo, që daton në kohën kur kanë filluar përpjekjet për ndërtimin e këtij impianti. Sasia e depozitimit në fushën e venddepozitimit të mbetjeve, së bashku me mbetjet që vinin nga ish-komunat, në kohën kur bashkia ishte involvuar e gjitha në zgjidhjen e këtij problemi, ishte 180 tonë në ditë. Kjo ishte arsyeja pse Bashkia e Fierit, kryetari i saj, këshilli bashkiak kanë qenë reagues ndaj çdo komunikimi dhe për të marrë çdo vendim të mëtejshëm është mbledhur këshilli. Pas ardhjes së kësaj shkrese nga koncesionari në datë 7.11.2016 këshillit bashkiak të Fier i është paraqitur një relacion, me anë të së cilit i është kërkuar të ngrejë një komision për të identifikuar zonën e re ku do të ngrihej impianti. Unë dua t'ju them këtu edhe një herë që të gjithë anëtarët e këshillit, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike, të maxhorancës dhe opozitës, të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Partisë së Lëvizjes Socialiste për Integrim kanë qenë dakord për ndërtimin e impiantit dhe i kanë kërkuar ekzekutivit të Bashkisë së Fierit të përgatisë një material me variante të mundshme për vendin e ndërtimit të këtij impianti. Grupi i punës, që është ngritur në këtë rast me urdhër të kryetarit të bashkisë, ka afruar 10 variante dhe këshilli ka zgjedhur një prej tyre, ka zgjedhur variantin nr. 4, e ka zgjedhur me unanimitet dhe është varianti ku sot është ngritur impianti i Fierit, pra fshatin Mbrostar.

Është diskutuar gjerë e gjatë në komisionin hetimor, është bërë kallëzim për kryetarin e Bashkisë së Fierit për ndryshimin e kategorisë së tokës ku do të vendosej impianti i trajtimit të mbetjeve Fier. Kjo, në fakt, u sqarua nga kryetari i bashkisë, del e qartë nga plani i përgjithshëm vendor i bashkisë, që është konfirmuar me shkresën e prefektit të datës 14.12.2016, është miratuar gjithashtu nga KKT-ja me vendimin e saj nr. 5, datë 26.12.2016. Sipërfaqja e tokës ku sot ngrihet impianti i Fierit, sipas planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë së Fierit, identifikohet si pjesë e infrastrukturës dhe për këtë shkak kategoria e tokës u ndryshua nga tokë arë në tokë truall. Këtë diskutim e gjejmë të sqaruar edhe në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Po kështu, është aluduar që nuk ka pasur asnjë dëgjese me komunitetin. Në fakt, në gjykimin që është zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit është paraqitur një material me 69 faqe, i shoqëruar me fotografi, në të cilin tregohet qartësisht se këto dëgjesa kanë ndodhur me një numër të lartë pjesëmarrësish, jo me një numër të ulët, për të justifikuar se janë bërë në mënyrë formale. Kjo ka ndodhur disa herë.

Situata në të cilën u operua për ndërtimin e impiantit të Fierit nuk ka qenë një situatë e qetë, sepse banorët, të nxitur edhe nga partitë politike, Partia Demokratike dhe LSI-ja, kanë protestuar për ngritjen e impiantit të Fierit në forma dhe mënyra të ndryshme, kanë bërë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe pastaj gjykimi ka vazhduar edhe në shkallën e dytë. Pas vitit 2017, kur LSI-ja u nda, prishi aleancën me Partinë Socialiste, dhe iu bashkua Partisë Demokratike, deputetë të Partisë Demokratike së bashku me deputetë të LSI-së u vunë në krye të këtyre protestave që, në fakt, synonin t'i fiksonin njerëzit, duke u thënë se këtu do të vijë plehra nga e gjithë bota. Sigurisht, e gjithë kjo nxitje prodhoi ato protesta dhe ato vonesa për ndërtimin e impiantit të Fierit.

Sa i takon një aludimi tjetër ose një akuze tjetër, se ndoshta fjala aludim është shumë e vogël përballë fjalës akuzë, të përdorur qëllimisht, që impianti i Fierit parashikohej të ndërtohej në tokë publike dhe u ndërtua në tokë private, për t'u shërbyer pastaj qëllimeve të privatit nëpërmjet vlerës së shpronësimit



që qeveria e dedikoi me vendimin përkatës të saj, kjo është krejtësisht e rreme, në fakt, sepse edhe vendi ku u planifikua të ndërtohej më parë ky impiant, i përcaktuar nga vendimi i këshillit bashkiak, fshati Mbyet, pra prona ose sipërfaqja e tokës ku pretendohet të shtrihet impianti është një sipërfaqe toke private, pra më shumë se 90% e saj është pronë private, janë parcela private, është tokë bujqësore, e ndarë me ligjin nr. 7051, ku për më shumë se për 30-40 vjet fermerët aty kanë kultivuar kultura të ndryshme, kanë kultivuar pemë dhe drurë frutore. Vetëm kjo e dhënë duhet t'ju bëjë të kuptoni se, nëse impianti do të ndërtohej atje, sigurisht që do të shpenzohej një vlerë jo vetëm për shpronësimin e tokës bujqësore, por edhe të të gjitha kulturave bujqësore të mbjella mbi atë sipërfaqe toke. Ne e thamë arsyen pse nuk u realizua aty, nuk u realizua aty sepse ishte e pamundur nga pikëpamja teknike, ndërkohë vendi tjetër, në të cilin u realizua ky impiant, ishte një vendimarrje e prodhuar me unanimitet nga këshilli i Bashkisë së Fierit, çka përjashton totalisht mundësinë e bashkëpunimit të një të interesuari me persona të tjerë. Kjo ishte arsyeja kryesore pse ndërtimi i këtij impianti zgjati dhe pse zëra të caktuar brenda kontratës së këtij impianti janë zgjatur, por jo kontrata në vetvete. Sot që flasim ia vlen të dihet nga gjithsecili që bashkitë Fier, Lushnjë, Roskovec dhe Patos, në kohë të shkurtër edhe ato të Divjakës dhe Mallakastrës i depozitonin mbetjet te ky impiant, pra çojnë atje çdo ditë 170-180 tonë mbetje.

Në bazë të një procedure koncesionare, të njoftuar rregullisht edhe në faqen e Agjencisë Së Publikimeve Publike është arritur të zbatohet kjo kontratë koncesionare dhe të ngrihet ky impiant. Ndërkohë, fusha e mbetjeve në Fier është rehabilituar në masën 70%, në të janë mbjellë mbi 5 mijë drurë akacie dhe eukalipte, nuk ekziston më reja toksike mbi Fierin; mbetjet e Bashkisë Fier, përfshirë këtu edhe 9 njësitë administrative të saj, mbledhen me mjete ekologjike, nëpërmjet një stacioni transferimi, të ngritur nga vetë Bashkia Fier, me anë të dy mjeteve të tonazhit të lartë transportohen në impiant. Pozicioni gjeografik i vendndodhjes së impiantit është i përshtatshëm edhe për bashki të tjera, veç asaj të Divjakës dhe Mallakastrës, që janë pjesë e qarkut Fier, si Bashkia e Dimalit, Bashkia e Kuçovë, Bashkia e Berat. Kështu që, i ftojme kryetarët e këtyre bashkive ta konsiderojnë këtë impiant si një zgjidhje optimale për trajtimin e mbetjeve, por sigurisht duke u siguruar për kostot e operimit, ndërkohë që bashkitë e qarkut të Fierit sot e kanë marrë zgjidhjen për mbetjet që krijohen në territorin e tyre. Parimi "Kush ndot, paguan", është një parim që duhet ta kuptojmë drejt nëse duam mjedis të pastër. Është tërësisht e pavend të pretendosh që do të sigurosh mjedis të pastër pa harxhuar asgjë. Kjo ndodhte në kohën kur 50% e mbetjeve hidheshin në kosh dhe 50% e mbetjeve shkonin në lumenj ose dete. Sigurisht, atëherë nuk kishte se për çfarë buxheti të diskutohej, vetëm nëse diskutohej për jetët e humbura të njerëzve për shkak të cilësisë së ajrit ose për vuajtjet afatgjata në shëndetin e njerëzve.

Nëse do t'i përmbledhnim gjërat, për impiantin e Bashkisë së Fierit do të më duhet t'ju them edhe një herë se në procedurën e ndjekur nga Bashkia e Fierit nuk ka pasur asnjë shkelje sa i përket ushtrimit të kompetencave të veta qoftë nga këshilli bashkiak, qoftë nga kryetari i bashkisë. Të gjitha vendimet kryetari i bashkisë i ka marrë në këshillin bashkiak. Të gjitha vendimet janë marrë në unanimitet të të gjithë këshilltarëve të Bashkisë së Fierit. Kryetari i Bashkisë së Fierit në asnjë rast të vetëm, dhe nuk u provua, nuk ka disponuar pa marrë vendimarrjen e këshillit. Gjithashtu, i pavërtetë ka rezultuar edhe pretendimi tjetër i opozitës, se ndryshimi i vendit, që e sqaruar, nga një pronë shtet, që, në fakt, nuk ishte pronë shtet, sepse ishin toka të fermerëve, madje këshilli i Bashkisë së Fierit, përpara se

koncesionari të njoftonte për ndryshimin e vendit ku do të ndërtohet impianti, kishte marrë vendim që të niste procedurat shpronësimit. Kjo tregon qartësisht se ata po mendonin se do të operohej në një tokë private, jo në një tokë publike, se ndryshe për çfarë do t'i nisnin procedurat e shpronësimit. Për këtë rast opozita pretendon se shtetit i është shkaktuar një dëm prej 46 milionë lekësh, një dëm i cili nuk qëndron, sepse shpronësimi është bërë në këtë vlerë dhe sipërfaqja e tokës ku ngrihet impianti i Fierit është sot një sipërfaqe, e cila i takon Bashkisë së Fierit.

Është krejt e qartë që nuk mund të pretendosh krim ekonomik dhe dëm financiar kur një ent publik ose një bashki, nëpërmjet një shume të caktuar monetare, shton asetet e veta me pasuri të paluajtshme, siç është kjo sipërfaqe toke. Bashkia e Fierit është bërë pronare e sipërfaqes së tokës së shpronësuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 951, datë 28 dhjetor të vitit 2016, për një sipërfaqe, e cila është realisht shumë e madhe, është 111564 metra katrorë. Kjo është sipërfaqja mbi të cilën është ngritur impianti i Fierit për të operuar për të gjithë qarkun e Fierit. Të gjitha problematikat që janë ngritur në lidhje me këtë koncesion gjejnë përgjigje në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Këtë gjë duhet ta përsërisim, sepse ne, ligjvënësit, nuk mund të vëmë në diskutim një vendim gjyqësor të formës së prerë. Duhet të heqim dorë nga kjo sjellje, që merr përsipër, me guxim të çartur, të mos respektosh, të mos njohësh, të injorosh, të mos i shohësh, të mos i pranosh konkluzionet e vendimit të formës së prerë të gjykatës.

Neni 3 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore” na thotë qartësisht se komisionet hetimore nuk mund të ngrenë akuza penale dhe nuk mund të ushtrojnë funksionet dhe atributet e një gjykate. Pra, është e qartë, edhe nga kaq gjë, që komisioni hetimor dhe më tej Kuvendi nuk mund të ushtrojnë atributet e një gjykate më të lartë, duke injoruar një vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Tiranës, të Apelit të Tiranës, që ka legjitimuar lejen e ndërtimit, që ka legjitimuar lejen mjedisore, që ka legjitimuar ndryshimin e kategorisë së truallit, që ka legjitimuar në vetvete, edhe nëpërmjet këtij ndryshimi, vendimin që mori Këshilli i Ministrave për të shpronësuar tokën në të cilën është ngritur sot impianti i Fierit. Të vijmë te praktika e fundit, te praktika koncesionare e Tiranës, e cila është një praktikë që me plot gojë mund të konsiderohet si një koncesion i pastër, në ndryshim nga dy praktikat e tjera koncesionare, që janë PPP. Më duhet të theksoj që në rastin kur të gjitha bashkitë e qarqeve Elbasan dhe Fier çojnë plehrat e tyre atje, ky shërbim bëhet me zero tarifë, pra nuk kanë asnjë kosto për këtë që kanë bërë dhe do të vijojnë të bëjnë. Impianti i trajtimit të mbetjeve urbane Tiranë Cilat janë të dhënat kryesore të kësaj kontrate? Autoritet kontraktues edhe këtu është Ministria e Mjedisit, koncesionari emri i kompanisë “Integrated Energy BV SPV”, kontrata koncesionare është e formës bot, kontrata e Tiranës është lidhur më 31.08.2017, me një afat prej 30 vjetësh, pra afati mbaron në vitin 2047, ende nuk ka mbaruar ky afat. Vlera e kontratës është 128 milionë euro dhe vendndodhja e përcaktuar në kontratë është Sharra.

Në lidhje me trajtimin dhe menaxhimi i mbetjeve, këtu dua të bëj një parantezë, ka qenë dhe mbetet një sfidë për shtetin shqiptar. Së pari, sfida deduktohet nga strategjia, e cila mbështetet në 4 shtylla kryesore: në planifikim; në edukim; në burime dhe në legjislacion. Në qoftë se kemi ecur me planifikimin dhe kemi përcaktuar se Shqipëria do të pastrohet dhe mbetet që krijohen në territorin e Republikës do të trajtohen të ndara sipas 10 rajoneve, nuk është se kemi ecur me të njëjtat hapa sa i takon edukimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të kësaj çështjeje. Kultura qytetare në drejtim të diferencimit në

burim, është një kulturë e munguar. Kultura qytetare në drejtim të mbajtjes pastër dhe ruajtjes së mjedisit, është po ashtu një kulturë e munguar dhe nuk besoj se ka nevojë të sjellim prova për këtë gjë, se prova e gjallë jemi ne vetë, të gjithë bashkë. Ndërkohë, me legjislacionin është bërë progres në Shqipëri dhe këtë e referoj edhe në bazë të të dhënave që INSTAT-i i ka vënë në dispozicion komisionit hetimor.

Dua t'ju them diçka sa për të pasur një ide të përgjithshme për atë që ndodh në Shqipëri: çdo person, çdo qytetar që jeton në republikën e Shqipërisë krijon mesatarisht 1,4 kilogramë mbetje çdo ditë. Këtë të dhënë nëse do ta shumëzohet me numrin e qytetarëve që banojnë dhe jetojnë në vendin tonë, atëherë e marrim me mend se sa e madhe është sasia e mbetjeve që krijohet, por edhe sa e madhe është në të njëjtën kohë përpjekja serioze që kërkohet për t'i menaxhuar këto mbetje në mënyrën e duhur, jo thjesht për t'i hedhur, se kështu ndodhte, thjesht hidheshin dhe pastaj u vihej zjarri. Kapacitetet njerëzore janë të rëndësishme, sepse është rasti që të investohemi në drejtim të sigurimit të kapaciteteve profesionale, të atyre që e njohin mjedisin. Fatkeqësisht, në komisionin hetimor u dëgjua çdo gjë, por ekspertë të vërtetë mjedisi nuk dëgjua, megjithëse, në fakt, vendin e tyre e zuri opozita. Opozitën e pamë që, në mënyrë të ethshme, të bënte edhe policin, edhe prokurorin, edhe gjyqtarin, madje edhe ekspertin mjedisor, të gjitha këto role i bëri, sepse i duheshin në funksion të gënjeshtërisë së vet, që të aktronte të gjitha rolet, por publiku nuk e dëgjoi. Ndjesë publikut që nuk dëgjoi ndonjë ekspert mjedisor, për të kuptuar se sa e madhe ka qenë gënjeshtria në këtë rast dhe pse i duhej opozitës që të ngjizte një gënjeshtëri kaq të madhe, e cila rezultoi që u zmadhua dita – ditës dhe kërkoi që të shkëpuste vëmendjen, ende kërkon ta bëjë këtë gjë, nga zhvillimet degraduese ndaj një partie politike, që përfaqëson edhe opozitën më të madhe numerike në vend.

Megjithatë, qytetarët nuk dëgjuan ekspertët mjedisorë, por ata janë në qytetet e tyre, ata që janë në Elbasan, në Fier, në Durrës, në Tiranë apo në bashkitë e këtyre qarqeve, dhe e kanë të qartë tanimë se ku shkojnë mbetjet që krijohen në qytetet e tyre. Po flisim për legjislacionin. Legjislacioni më i debatuar ka qenë ai i koncesioneve, një legjislacion i propozuar në kohën e qeverisjes së Partisë Demokratike, mbi bazën e të cilit u operua për ndërtimin e këtyre impianteve, por që rrugës, edhe për shkak të zbatimit praktik të ligjit, edhe për shkak të ndryshimit të direktivave në fushë nga BE-ja dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, të njohur për autoritetin e tyre, kanë bërë të mos qëndrojmë indiferentë, sepse kemi propozuar ndryshime në legjislacion. Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet”, i ndryshuar më 6 nëntor 2018, ka ndryshuar në disa pika të rëndësishme. Së pari, janë hequr propozimet e pakërkuara për një sërë sektorësh dhe ai që na intereson këtu është sektori i trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve. Në vijim, për këtë sektor nuk mund të ketë më projekte ose kontrata, që fillësen e tyre do ta kenë në propozime të pakërkuara, sepse ka rënë ky parashikim i ligjit. Ky ndryshim ishte në harmoni edhe me rekomandimet e Komisionit Europian dhe direktivën e tij për dhënien e kontratave të koncesionit. Po kështu është hequr bonusi për propozimet e pakërkuara, sepse më se një herë qeveria është akuzuar që ka dhënë bonus, por qeveria këtë bonus nuk e ka dhënë nga xhepi, por e ka dhënë për shkak se e parashikonte ligji. Është hequr edhe kjo pjesë dhe, me qëllim rritjen e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët në procedurën konkurruese, iu hoq mekanizmi i shpërblimit me pikë bonus të gjithë atyre operatorëve që paraqesin propozime të pakërkuara. Pas datës 1 korrik 2019 nuk ka më sisteme të tilla, të shpërblimit me pikë bonus dhe për të nxitur sektorin privat, që të jetë mbështetës

në projekte që natyrisht nuk mund të realizohen thjesht dhe vetëm nga qeveria, sistemi i pikëve me bonus është zëvendësuar me atë të kompensimit me vlerë monetare të propozuesit të pakërkuar në qoftë se ky nuk shpallet fitues. Në çdo rast vlera e kompensimit është simbolike, sepse nuk kalon 1% të vlerës së investimit. Është forcuar roli i ministrit përgjegjës për Financat në ndryshimet e bëra në ligj. Qëllimi është i qartë, të përcaktojë më mirë rolin dhe përgjegjësinë e Ministrisë së Financave në lidhje me miratimin e të gjitha projekteve të koncesionit, PPP, dhe ecurinë e kontratave koncesionare.

Kontratave koncesionare, projektet koncesionare nuk janë më kot projekte të debatueshme, janë për faktin se janë komplekse, janë afatgjata, në vetvete implikojnë risqe për shkak se janë afatgjata, dhe si të tilla është e nevojshme që të gjitha këto projekte, edhe ato pa mbështetje, me financa nga buxheti i shtetit, edhe ato që kërkojnë mbështetje nga buxheti i shtetit, të gjitha duhet të miratohen paraprakisht nga Ministria e Financave, që është përgjegjëse për vlerësimin dhe miratimin në këndvështrimin e implikimeve që mund të sillte në buxhetin e shtetit. Një ndryshim tjetër i ligjit, që unë e konsideroj po aq të rëndësishëm, është fakti që tanimë kontratat koncesionare, para se të nënshkruhen, duhet të kalojnë sërish në filtrin e ministrit përgjegjës për Financat. Ndryshimi i fundit i bërë në atë ligj, që besoj e kompletton tërësisht nevojën e lindur nga përmirësimi i ligjit për koncesionet, është pikërisht parashikimi që ka lidhje me komitetin e përzgjedhjes së projekteve të koncesionit. Përzgjedhja e projekteve të koncesionit nuk do të jetë më një përzgjedhje individuale, por do të jetë një përzgjedhje, që do të bëhet nëpërmjet një komiteti, që mban të njëjtin emër, pra një organ kolegjal, i cili do të asistohet nga një ekspertizë e kualifikuar dhe që, natyrisht, prej datës 1 korrik të vitit 2019 ka për detyrë këtë gjë.

Ne në komisionin hetimor kemi administruar një shkresë, që na ka ardhur nga Ministria e Mjedisit, është një shkresë e kërkuar nga opozita në fakt, në të cilën na bëhet me dije që në vitin 2015 Sharra e mbaronte funksionin e vet, pra ishte projektuar për të funksionuar deri në vitin 2015. Kjo ka qenë edhe arsyeja, në fakt, pse Bashkia e Tiranës, kryetari i saj, më saktë, që edhe ai është në vetvete një autoritet përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve në Tiranë, jo vetëm të qytetit, por edhe të ish-komunave, që sot janë bashkuar si njësi administrative, i ka drejtuar një shkresë ministrit të Mjedisit të kohës, ku i kërkonte që të asistojë çështja e trajtimit të mbetjeve në Tiranë. Ia kërkonte këtë gjë Ministrisë së Mjedisit, duke i thënë që të asistojë edhe nëpërmjet PPP-ve, sepse e vërteta është që, kur Bashkia e Tiranës drejtohej nga zoti Basha, që e kemi në sallë, ka pasur studime, dhe studimet nuk bëhen falas, për ato paguhet, të cilat orientonin që bashkia nuk i ka kapacitetet intelektuale dhe as ato financiare që ta merrte përsipër pastrimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, por nevojitej një partneritet publikprivat. A mori përgjigje shkresa e kryetarit të Bashkisë së Tiranës ditën e nesërme ose orën më pas, siç e keni zakon ta thoni ju? Jo, nuk është zgjidhur të nesërmen, madje nga komunikimet shkresore na rezultoi që përgjigja ka ardhur një vit më pas. Sharra e kishte mbyllur funksionin e vet, në malin shkumbues atje vazhdonin zjarret dhe tymrat.

Përgjigja ka ardhur një vit më pas dhe i referohej një propozimi të pakërkuar, që ndërkohë i ishte paraqitur Ministrisë së Mjedisit nga një bashkim operatorësh. Ndalemi një moment te kjo pikë. Është folur shpeshherë për operatorët dhe për emrat e kompanive. Unë nuk e di nëse emrat e kompanive ju thonë diçka, përveç atyre që kanë lidhjet e tyre të interesit, apo nuk e di çfarë, me kompanitë, dhe ndoshta e kuptojnë se cilat janë kompanitë, por sjellja e operatorëve privatë, si i ndërtojnë ata kompanitë, ku i ndërtojnë ata kompanitë, me kë bashkëpunojnë ata, kush janë ortakë apo

administratorë të tyre, ky nuk mund të jetë objekti i një hetimi parlamentar, pasi parlamenti ka detyrë të hetojë sjelljen e aktorëve shtetërorë dhe, në çdo rast, këtë e bën për qëllime të interesit publik, nuk e bën për asnjë lloj qëllimi tjetër. Këtë thotë ligji. Nëse dikush nga operatorët privatë, edhe në rastet që flasim, ka bërë shkelje apo i është shmangur ligjit nga zbatimi i tij, pa dyshim që organet e drejtësisë e kanë detyrimin dhe e kanë mundësinë të pakufizuar për t'i sanksionuar ato.

Ne jemi këtu në momentin që Bashkia e Tiranës i kërkon Ministrisë së Mjedisit që të asistojë për zgjidhjen e problemit të plehrave në Tiranë dhe, ndërkohë, Bashkia e Tiranës ia bën me dije Ministrisë së Mjedisit situatën në Sharrë. Ju mund të keni në mendje emisione televizive të bëra për Sharrën, por e gjitha është e materializuar edhe në letra. Sasia totale e mbetjeve të depozituara nga Bashkia e Tiranës në Sharrë deri në vitin 2015, këtu nuk e kemi fjalën as për Kamzën, as për Vorën, as për Kavajën, as për Durrësin, ishte 200 275,2 tonë mbetje, mbi 200 mijë tonë mbetje, ndërkohë që Tirana, sipas censusit, më 01.01.2016 kishte 780 531 banorë. Edhe këtu ju ftoj të bëni një veprim të thjeshtë aritmetikor, ju ftoj të përdorini celularët për siguri, ku mund kuptoni lehtësisht sesa e madhe ishte sasia e mbetjeve të krijuara nga çdo qytetar që jeton në qarkun e Tiranës, një qark me sipërfaqe prej 1586 km<sup>2</sup>, ku popullsia në vitin 2011, 11 vjet më parë, ishte 749 365 banorë, ndërkohë sot Tirana i ka kaluar 1 milion banorë. Menjëherë pas këtij komunikimi, autoriteti kontraktor ka filluar procedurën e tij të punës, me ngritjen e komisionit për koncesionin, ka pranuar dhe filluar shqyrtimin e propozimit të pakërkuar, duke bërë një vlerësim paraprak nga ana formale, ligjore, teknike e të tjerë. Ngritja e komisionit nga autoriteti kontraktor ka përfunduar në muajin shtator të vitit 2016. Përbërja e këtyre komisioneve ka qenë e ndryshme, ka pasur dy përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, ka pasur një përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe dy përfaqësues nga bashkitë, në rastin konkret kanë qenë dy përfaqësues nga Bashkia e Tiranës.

Komisioni ka bërë disa mbledhje, të gjitha mbledhjet janë të materializuara dhe të dokumentuara në procesverbalet përkatëse, që lexohen qartësisht. Unë nuk dua të ndalem shumë këtu, sepse, për shkak që një pjesë e mirë e anëtarëve të këtij komisioni janë pyetur nga prokuroria, ishte një ndalesë ligjore për komisionin hetimor parlamentar që këto prova, të cilat sot janë në duart e prokurorisë, të merreshin edhe nga parlamenti, sepse kjo qartësisht do të tregonte më mirë që parlamenti ishte duke kryer diçka që nuk i takonte, që, në fakt, edhe kreu, nuk e ndryshojmë dot këtë fakt. Për Tiranën Këshilli i Ministrave ka marrë dy vendime. Vendimi i parë është ai që ka të bëjë me miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepej shoqërisë koncesionare, VKM-ja nr. 855 datë 07.12.2016. E thamë dhe nuk kam dëshirë ta përsëris edhe një herë, që bonusi jepej si rezultat i ligjit, të cilin më vonë ne e ndryshuam edhe falë rekomandimeve dhe direktivave në fushë të Bashkimit Europian. Debati nëse duhet apo nuk duhet incenerimi, unë e quaj të tejkaluar për faktin që ligji "Për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve", i cili është një ligj i viti 2011, e ka në përmbajtjen e vet të përkufizuar këtë koncept, pra incenerimin. Madje në nenin 3 të tij, ky ligj e trajton incenerimin si një nga metodat për trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve. Vendimi i dytë që ka marrë Këshilli i Ministrave në lidhje me procedurën e Tiranës është vendimi për shpronësimin. Vendimi është i datës 26.12.2018 dhe mban numrin 811. Shpronësimin e ka bërë qeveria, nuk e ka bërë Bashkia e Tiranës, dhe vlera e përgjithshme e shpronësimit është 284 995 840 lekë. Kjo vlerë i është alokuar Bashkisë së Tiranës, në mënyrë që ajo të

vazhdonte procedurën e shpronësimit. I gjithë përballimi i shpenzimeve në këtë rast është bërë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i cili ishte miratuar rregullisht në vitin 2018.

Ne këtë përgjigje e kemi marrë edhe nga shkresat që kemi administruar nga Këshilli i Ministrave, e kemi marrë edhe nga kryetari i Bashkisë Tiranë, i cili na ka vënë në dispozicion të plotë të gjitha vendimmarrjet lidhur me impiantin e Tiranës. Shpronësimi i bërë sa i takon kontratës koncesionare të Sharrës, ose Tiranës, nga Këshilli i Ministrave tregon edhe një herë angazhimin e qeverisë për t'i dhënë zgjidhje një problemi madhor, sepse bëhet fjalë për Tiranën, kryeqytetin e Shqipërisë, ku presupozohet se konsumi rritet dita-ditës, ku Sharra, e cila kishte 25 vjet që i shërbente grumbullimit të mbetjeve për qytetin e Tiranë, e mbaroi funksionin e vet, Imagjiloni në më shumë se 25 vjet sa është rritur Tirana. Si mund të pretendohet që qeveria të ishte indiferente dhe të mos i jepte mbështetje Bashkisë së Tiranës për ta zgjidhur këtë problem?! Unë nuk i vë dot emër kësaj, po e lë kështu, sepse mendoj se opinioni publik fare mirë mund t'i vendos emër edhe kësaj përçartjeje të radhës. Për sa i takon statusit juridik të tokës, ku sot ngrihet impianti i trajtimit të mbetjeve të Tiranës, a e dini sa është sipërfaqja e tij?! Sipërfaqja është 120 hektarë, 60,1 % është pronë shtet dhe 39,9% është pronë private e shpronësuar. Kjo është një sipërfaqe e madhe, por e nevojshme dhe e domosdoshme, e cila është konceptuar për të kryer të gjitha aktivitetet e një kontrate të tillë koncesionare.

Ky projekt përfshin ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave kryesore dhe plotësuese, të cilat po i përmend: kapsulimi i venddepozitimit ekzistues (ju ftoj të shkoni në Sharrë, ish-fusha e mbetjeve në Sharrë, e cila u shndërrua në mal, nuk ekziston, pasi është e gjitha e kapsuluar, e gjelbëruar, e mbjellë me pemë dhe e pastruar totalisht, nuk ka lidhje fare me atë që ka qenë më parë. Vetëm dikush që nuk e ka parë nuk mund ta imagjinoj dot, por neve nuk na falet, sepse e kemi parë të gjithë); impianti i përpunimit të ujërave të ndotura; impianti i diferencimit të mbetjeve të integruara; venddepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane; impianti i përpunimit të mbetjeve; nënstacioni elektrik; venddepozitimi i hireve dhe venddepozitimi i mbetjeve inerte. Pra, vetëm nga kaq sa unë numërova, kuptohet lehtësisht që është një projekt tepër kompleks dhe, natyrisht, i përshtatet kryeqytetit. Pse duhej të ishte i tillë?! Duhej të ishte i tillë, sepse nuk e krahasojmë dot kryeqytetin, për nga numri i qytetarëve që jetojnë në të dhe për nga konsumi që ndodh çdo ditë në kryeqytet, me qytetet e tjera të Shqipërisë. Sigurisht, ne kemi menduar afatgjatë, nuk jemi duke menduar se çfarë do të ndodhë për 10 apo 15 vjet, por jemi duke menduar për një kohë shumë të gjatë. Shpronësimi është bërë në bazë të ligjit nr. 125/2015, në të cilin thuhet: “Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi, që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar”. Kjo, sepse edhe shpronësimi në vetvete ka ngjallur debat për opozitën.

Bashkia e Tiranës, për të kryer funksionin e pastrimit të qytetit, është mbështetur nga qeverisja dhe kjo nuk mund të mohohet, sipas vendimit të shpronësuar. A e dini sa ishte sipërfaqja shtesë e ish-fushës së Sharrës?! Sipërfaqja shtesë është 478 800 m<sup>2</sup>. Kjo është sipërfaqja, për të cilën është miratuar vlera e shpronësimit. Të kalojmë te pretendimi kryesor në lidhje me këtë kontratë dhe pretendimi që procedura koncesionare që po zhvillohej në Sharrë të miratohej me vendim nga këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky është një pretendim që nuk gjen shprehje dhe zbatim në ligj, prandaj thashë

që përmbledhjes që recitoi opozita edhe sot në Kuvend i mungoi analiza ligjore. Nuk dëgjuam në asnjë rresht të vetëm dhe në asnjë fjalë të vetme se ku është referenca ligjore, e cila të lejon apo të ndalon që ti të bësh një veprim të caktuar që ne të kuptojmë që kryetari i bashkisë, Ermonela dhe Jorida paskan shkelur ligjin. Pretendimi i opozitës në këtë komision hetimor në lidhje me marrjen e miratimit nga Këshilli Bashkiak Tiranë për sa i përket angazhimit financiar për këtë procedurë koncensionare, bëhet duke ngatërruar qëllimisht kompetencat dhe detyrat e këshillit në lidhje me miratimin e buxhetit, kompetenca të parashikuara në nenin 54, germa “dh” të ligjit, ku thuhet shprehimisht: “Këshilli bashkiak miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.

Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë”. Pra, nga kjo dispozitë, që unë lexova, del qartësisht se këshilli bashkiak shprehet vetëm në lidhje me miratimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ndryshimet që pëson ky buxhet dhe për këtë vendimmarrje është i detyruar kryetari i bashkisë që t’i referohet këshillit të bashkisë. Dhënia e miratimit në parim për një procedurë në proces, siç ishte procedura koncensionare e Sharrës, nuk është kompetencë e këshillit bashkiak. Shprehja parimisht dakord, që kryetari i Bashkisë së Tiranës i ka dhënë me shkresën e datës 27.03.2017 Ministrisë së Mjedisit nuk ka të bëjë me miratimin e buxhetit apo ndryshimeve të tij, por është një dakordësi e shprehur në parim, referuar studimit të fizibilitetit me termat, në të cilat propozohet zgjidhjet çështja së trajtimit të mbetjeve në Tiranë. Në vijim të këtij projekti, kompetencat e kryetarit të bashkisë përcaktohen qartë në pikën 12 të nenit 21 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar”, ku thuhet: “Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.”

Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 5 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” thuhet: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë”. Po të shkojmë pak më poshtë, në germën “gj” të nenit 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, thuhet: “Kryetari i Bashkisë ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët”. Ai ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit bashkiak, dhe cila është kompetencë vetëm e këshillit bashkiak dhe nuk e ka kryetari? Miratimi i ndryshimeve në buxhet dhe miratimi i numrit të punonjësve të të gjitha institucioneve që ka bashkia në varësi. Në komisionin hetimor, nga ish-ministri i Financave, zoti Arben Ahmetaj u shpjegua qartë edhe një herë autoriteti i ministrit të Financave lidhur me koncesionet/partneritetin publik-privat, sipas ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”. Edhe një herë, kolegë, Ministria e Financave jep miratimin paraprak për të dhënat dhe analizën ekonomiko-financiare, referuar fushës së saj të përgjegjësisë shtetërore që materializohet edhe në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe miratimi paraprak, që jep ministri i Financave, nuk ka të bëjë me asnjë konsideratë tjetër, që nuk është përballueshmëri, qëndrueshmëri dhe fizibilitet fiskal. Këtë detyrë ka ministri i Financave dhe këtë e shikon ministri i Financave. Çfarë është përballueshmëria e një projekti? Mbase edhe këto ia vlen t’i themi që të jemi të qartë me publikun. Në lidhje me përballueshmërinë e një projekti, që kërkon mbështetje financiare, Ministria e Financave

kontrollon nëse kostot përkatëse të projektit janë të planifikuara, nëse përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar nga Kuvendi, si dhe brenda tavaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Pretendimi se ka pasur pamundësi për vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës, sepse duhej me 3/5-at anëtarëve të tij, po ashtu nuk gjen mbështetje ligjore, sepse kështu është ngritur gënjeshtër për kryetarin e Bashkisë së Tiranës, nuk ka marrë vendim këshilli, sepse nuk i kishte 3/5-at, se kishin ikur këta të LSI-së dhe ishin bashkuar me ata të PDsë.

Në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”, në nenin 55 të tij përcaktohet qartësisht se kur duhen 3/5-at e këshillit bashkiak. Vendimet merren me jo më pak se 3/5-at e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e” të nenit 54 të këtij ligji dhe rasti është ai i tjetërsimit dhe dhënies në përdorim të pronave në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe në asnjë rast tjetër. Ma gjeni momentin kur Bashkia e Tiranës, në raport me këtë procedurë, është përballur me këtë nevojë. Përgjigjja, që rezulton në shkresën nr. 8275/1, datë 27.03.2017, pra përgjigjja e kryetarit të bashkisë, Erion Veliaj, dhënë Ministrisë së Mjedisit është korrekte, sepse nuk kemi të bëjmë as me miratim buxheti, as me ndryshime të tij apo me marrjen përsipër të një angazhimi 30-vjeçar në momentin që po flisnim, sepse kontrata ende nuk ishte lidhur dhe lidhja e kontratës ishte përgjegjësi e një autoriteti tjetër. Në momentin e parashikimeve buxhetore këshilli bashkiak ka ushtruar kompetencat e tij dhe ka ngarkuar kryetarin e bashkisë për të nënshkruar aktet dhe angazhimet përkatëse në vijim të kësaj procedure.

Angazhimi financiar nga Bashkia e Tiranës apo nga bashkitë e tjera të qarkut Tiranë, sipas parashikimeve që ka edhe vetë kontrata koncensionare, është marrë përsipër vetëm në momentin kur këto njësi kanë nënshkruar në formën e angazhimit, sipas aneksit X të kontratës, dhe kontrata është një dokument publik edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Përpara marrjes përsipër të formës së angazhimit nga Bashkia e Tiranës, në momentin kur kësaj njësie vendore i është përcjellë edhe kontrata koncensionare, e nënshkruar midis Ministrisë së Mjedisit dhe koncensionarit, Bashkia e Tiranës ka kryer të gjitha procedurat përkatëse, në përputhje me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Bashkia e Tiranës ka nënshkruar formën e angazhimit mbi detyrimet e njësisë vendore të qarkut të Tiranës, aneksi X i kontratës, në vitin 2018, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 106, datë 28.09.2017, ku me ndryshimet përkatëse në programin buxhetor ka ngarkuar kryetarin e Bashkisë së Tiranës për zbatimin e detyrimeve dhe angazhimeve të parashikuara në këtë vendim, si dhe nënshkrimin e akteve të nevojshme në zbatim të tij. Po kështu, me vendimin nr. 132, datë 21.12.2017, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë e Tiranës për vitin 2018” janë bërë parashikimet e nevojshme buxhetore në zbatim të kontratës koncensionare. Bashkia e Tiranës ka kryer komunikimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me angazhimin financiar të Bashkisë së Tiranës dhe sigurimin e mbështetjes financiare nga qeverisja qendrore, me qëllim kryerjen dhe përmbushjen e funksioneve të saj, sipas parashikimeve të kontratës. Pra, nga sa më sipër, rezulton se procedurat administrative të ndërmarra nga Bashkia e Tiranës janë kryer konform legjislacionit në fuqi, brenda kompetencave që parashikon legjislacioni, bazuar në zgjidhjen e propozuar për menaxhimin e mbetjeve për territorin e Bashkisë së Tiranës, një zgjidhje e cila nuk mund të na vinte nga ndonjë ent tjetër, përveçse nga autoriteti kontraktor që është Ministria e Mjedisit.



Ndërkohë, sjellim edhe një herë në vëmendje ligjin e Këshillit të Ministrave, sepse nuk janë akuzuar vetëm anëtarët e Këshillit të Ministrave në momente të ndryshme të vendimmarrjeve në lidhje me këto kontrata koncensionare, por edhe anëtarët e komisionit hetimor, përfaqësues të maxhorancës që kanë qenë ministra dikur. Pa dyshim, Këshilli i Ministrave, përpara se të miratojë një vendimarrje, ia orienton ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” që të realizojnë një proces, i cili njihet si proces i bashkërendimit të akteve. Sigurisht, nuk është një proces i jashtëzakonshëm, është një proces rutinë pune dhe, natyrisht, nuk është edhe ndonjë procedurë që të amplifikohet sikur kjo qeveri gjatë kohës që ftohej, investohej për vendimarrje të caktuara në lidhje me këto kontrata koncensionare të ketë ndjekur enkas këtë proces, bashkërendimin e akteve. Është një proces që ndodh gjithmonë për çfarëdolloj akti, për çfarëdolloj vendimarrje që bën Këshilli i Ministrave. Pa dyshim, është një punë që e detyron ligji, përfaqësuesit, kabinetet në institucione të ndryshme qendrore përfshihen në procesin e konsultimit të vendimmarrjeve që duhet të bëjë Këshilli i Ministrave nëpërmjet dhënies së vërejtjeve dhe dhënies së sugjerimeve përkatëse, derisa autoritetet qendrore të bien në dakordësi në shumicë për finalizimin e një akti të caktuar. A mund penalizohet dikush për mendimet që jep?! Sepse është kërkuar që njerëzit të vihen përballë akuzave për mendimet e ndryshme që ka dhënë gjatë kohëzgjatjes së ushtrimit të detyrave të tyre. Mendoj se përgjigjen e kësaj pyetje e ka dhënë Kushtetuta, e cila në nenin 22 garanton lirinë e shprehjes . Së dyti, ligji, i cili është që prej vitit 2003, pra nuk është një ligj i ndryshuar për të bërë diçka; anëtarët e Këshillit të Ministrave, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, duhet t’i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e qeverisë. Ata duhet të mënjanojnë në mënyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi, të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë apo jo në mbledhje, kanë votuar apo jo. Këshilli i Ministrave është organ kushtetues, është organ kolegjal për nga natyra e funksionimit dhe, sigurisht, një qeverie serioze i takon të shfaqet unitare në vendimmarrjen e vet, pavarësisht debateve dhe vlerësimeve që anëtarë të ndryshëm të kabinetit mund të ruajnë eventualisht për çështje dhe praktika të ndryshme pune. Ama, këto vlerësime dhe debate, sipas këtij ligji, mbeten konfidenciale. Këtë thotë ligji i Këshillit të Ministrave ende në fuqi, por kështu ka thënë ligji i Këshillit të Ministrave edhe në kohën kur ishit ju në qeverisje.

Ky adresim në të tilla parashikime ligjore, sigurisht, na vlen, sepse vlen për të rrëzuar çdo pretendim të opozitës për qenien në konflikt interesi të anëtarëve përfaqësues të maxhorancës në komisionin hetimor dhe për të cilët më parë thamë se kanë kryer detyrën e ministrave, sikundër njëherazi tregon, dhe kjo sigurisht nuk mund të ngelet jashtë vëmendjes, se nuk ka pasur asnjë urdhër të shprehur apo të nënkuptuar, i tillë që të impononte një vendimarrje të caktuar dhe dakordësi nga ana e të gjithëve. Përndryshe, nuk do të mund të faktohej që gjatë procesit të vendimmarrjes ka pasur edhe debate, ka pasur vërejtje, ka pasur sugjerime që janë reflektuar. Ajo që është më e rëndësishmja për t’u theksuar është që kontrata e Tiranës është koncesion i pastër, e cila nuk kërkon mbështetje financiare. Tirana është një koncesion i formës “Paguaj për të përdorur”, një kontratë me një tarifë shërbimi 29 euro. Impianti i Tiranës nuk ka kërkuar mbështetje financiare në kontekstin e nenit 42 të ligjit “Për koncesionet”, pasi është një investim tërësisht privat, prej 128 milionë eurosh, ku asetit pas 30 vjetëve do t’i transferohet Bashkisë së Tiranës. Unë besoj që ky shpjegim është bërë qartësisht për orë e orë të tëra në komisionin hetimor parlamentar, qartësim i bërë nga ish-ministri i Financave, zoti Ahmetaj.

Publikut duhet t'i ngelet në vëmendje kjo gjë nga sot, që në Sharrë do të ndodhë edhe incenerimi i mbetjeve të papërdorshme.

Kujtoj këtu se ne jemi brenda zërave të kontratës. Pra, landfillet e ndryshme që unë përmenda në Sharrë, ju ftoj t'i shihni, ndoshta ka qenë gjëja më e mirë që bëri komisioni hetimor, duke shkuar nëpër këto impiante, sepse i dha mundësi edhe medias, edhe publikut t'i shihte. Ju e dini që në media, për fat të keq, ka edhe tifoze politikë, që më se 1 herë u shfaqën në sallën ku zhvillonte mbledhjet e komisionit hetimor parlamentar dhe me "sms" përpiqeshin të moderonin edhe mbledhjen. Më thoni, nëse e vërteta ka nevojë që dikush ta monitorojë nga jashtë, opozitës, që pretendon se ka zbuluar të vërtetën, nuk e di ç'i duheshin edhe këta opinionistët dhe mendimtarët e pavarur?! E vërteta del në dritë, nuk mund të fshihet. Pra, në Sharrë do të ndodhë incenerimi i mbetjeve. Po ngrihen të dyja impiantet që do të bëjnë incenerimin e atyre mbetjeve (pra, jo të të gjitha mbetjeve) që nuk mund të seleksionohen, nuk mund të riciklohen, pra që janë thjesht të papërdorshme dhe si të tilla do të duhet të digjen.

Vlera e investimit është vetëm vlera e investuar nga koncesionari dhe kjo vlerë nuk mund të njësohet me tarifën për ton mbetje që paguhet nga të gjithë ata që e përdorin këtë shërbim, përfshirë Bashkinë Tiranë. Për çdo ton mbetje urbane, që dërgohet në Sharrë nga Bashkia Tiranë, por tani edhe nga Bashkia Durrës, edhe nga Kavaja, paguhet tarifa prej 29 eurosh për ton. A është kjo një tarifë disproporcionale, po ta krahasojmë me tarifa që përdoren gjithkund ku ka inceneratorë? Në fakt, ne e kemi bërë këtë krahasim, kemi mbledhur të dhëna statistikore dhe kemi parë që kjo tarifë qëndron në mes të këtyre tarifave. Nuk është një nga ato tarifa që të kërcasë dhe të të bëjë ty të mendosh që këto impiante u ndërtuan me qëllimin për të përfituar qeveritarët nga ndërtimi i tyre. Për provueshmërinë në këtë rast, fatmirësisht, na ka ndihmuar edhe një shkresë që kemi administruar nga Bashkia e Tiranës në kohën kur kjo bashki drejtohej nga zoti Basha. Ka pasur një studim të Bankës Botërore, i cili propozonte tarifën 37 euro për ton dhe bëhej fjalë për landfill, nuk bëhej fjalë fare për impiant, ndërsa ne po flasim për impiant me të gjitha këto landfille brenda, përfshirë incenerimin, dhe kemi 29 euro për ton. Ndërkohë, Banka Botërore, sipas një studimi të paguar nga Bashkia Tiranë, kur kjo bashki drejtohej nga zoti Basha, ka marrë vlerën 37 euro për ton mbetje për landfill.

Komisioni hetimor ka administruar, po ashtu, një listë të të dhënave të tarifave për ton mbetje dhe sasive të mbetjeve urbane që krijohen në vende të ndryshme të Europës. Sigurisht, opozita kërkoi të përdorte si provë të kundërt raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në fakt, nuk do të doja ta ezauroja këtë minutazh të gjatë për të folur për Kontrollin e Lartë të Shtetit, ndaj do të limitohem të them që sigurisht është institucion i rëndësishëm, është institucion kushtetues, duhet të jetë i pavarur... "A ka qenë ai i tillë?", është një diskutim tërësisht tjetër, por dua të kujtoj që në kohën kur janë bërë këto raporte, ish-kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkruer i këtyre raporteve, përveçse rezultonte që ishte një ministër në qeverisjen e PD-së, sot është deputet i kësaj force politike. Nga ana tjetër, se kjo nuk ka pikë rëndësie, aktet që nxjerr Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk janë vendime gjyqësore të formës së prerë, janë akte që kontestohen në rrugë gjyqësore dhe në rrugë administrative, gjë e cila do të thotë që çfarëdolloj gjëje që pohohet në raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk janë të tilla, nuk janë fakte dhe as prova për komisionin hetimor që të merren apriori si të tilla nga ana jonë. Nëse Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kapur mospërmbushje kontraktore gjatë auditimit të kontratave koncesionare të Elbasanit e të Fierit, sigurisht që mospërmbushjet kontraktore, në radhë të parë, trajtohen civilisht, por nëse në

grykimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit këto kanë qenë edhe vepra penale, do të duhet t'i kishte kallëzuar.

Ne nuk u ballafaquam me asnjë dokument që të na tregonte se Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili paska kapur shkelje kaq të mëdha, që në grykimin e opozitës përbëjnë vepra penale, të kishte bërë edhe kallëzim. Nuk ka bërë ndonjë kallëzim Kontrolli i Lartë i Shtetit për rastet që ka audituar, por, sigurisht, është dhe mbetet detyrim i tij që, nëse ka shkelje të tilla, që mendon se përbëjnë vepra penale, t'i kallëzojë në prokurori. Një moment tjetër, që u kërkua të hetohet në komisionin hetimor në rastin e Tiranës, kishte të bënte me Durrësin dhe me mbylljen e Porto Romanos për t'u shndërruar në një ecopark. Ju pëlqen ose jo, ne jemi krenarë që e kemi mbyllur Porto Romanon dhe e kemi shndërruar në një Eco Park. E thashë, ishte vulë turpi për të gjithë ne, ndërkohë që sot do të duhet të jemi mirënjohës që ka pasur një vendimmarrje shumë serioze nga ana e qeverisë për ta mbyllur atë pikë dhe për ta shndërruar në një ecopark, një gjë që, në fakt, është vlerësuar edhe nga njerëz që nuk kanë kurrfarë lidhjeje me politikën. Mjafton vetëm të shfletosh dhe të shohësh që ka shkrime të ndryshme, veçanërisht nga persona të cilët e njohin mjedisin, trajtojnë çështjet e ekologjisë dhe kanë vlerësuar që Porto Romano shkakton një ndotje të jashtëzakonshme për Durrësin për shkak të mbetjeve, për shkak të rrjedhjeve toksike drejt nëntokës dhe detit, për shkak të gazrave me përmbajtje të substancave toksike kancerogjene, të cilat, sigurisht, përfundonin në mushkëritë e qytetarëve, por edhe të studentëve nga e gjithë Shqipëria, që studionin në qytetin e Durrësit. Ama, ky realitet sot është fshirë dhe është një lajm shumë i mirë që Sharra i shërben sot edhe Durrësit. Durrësi është qytet bregdetar. Të mos harrojmë që së bashku me Vlorën përballohen vetëm në sezonin turistik mbi 1 milion vizitorë të ndryshëm, vendas dhe të huaj.

Sigurisht, problematika e mbetjeve bëhet edhe më e theksuar si përgjegjësi për t'u marrë përsipër dhe për t'u çuar deri në fund nga ana e bashkive, por me Sharrën ne i kemi shërbyer Durrësit, sepse e kemi larguar pikën e trajtimit të mbetjeve 40 kilometra nga një qytet bregdetar, nga qyteti më i madh bregdetar në Shqipëri. Po kthehem edhe një herë tek Instituti i Statistikave, se edhe kjo është një pikë e rëndësishme. Deri në vitin 2013 të dhënat e mbledhura dhe statistikave të publikuara ishin të pakta e përgjithësisht të referuara në rekorde administrative, raportuar këto nga burimet administrative të kohës. Lidhur me sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara gjithsej, të raportuara për periudhën 2004-2022, janë gjeneruar gjithsej 745249 tonë mbetje. Ndërkohë, nga viti 2013 e në vazhdim, në drejtimin metodologjik të asistencave teknike të udhëhequra nga Bashkimi Europian, por duke u mbështetur edhe në eksperiencën më të mirë ndërkombëtare, të dhënat mbi gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane, kanë pësuar ndryshim rrënjësor në strukturë, sasi dhe metodologji për sa u përket mbledhjes, llogaritjes dhe publikimit të tyre. Lidhur me sasinë mesatare të mbetjeve, të raportuara tanimë për periudhën 2013-2020, janë gjeneruar rreth 1 milion e 606 mijë e 639 tonë mbetje. Dhe kjo është një e dhënë e saktë, nuk është si të dhënat e para vitit 2013, që ishin të dhëna të shpërndara, të dhëna që merreshin tektuk, të dhëna që grumbulloheshin pa zbatuar as ndonjë metodologji të caktuar apo ndonjë lloj standardi të caktuar në përpjekjen për t'i mbledhur këto të dhëna. Prandaj thashë që qeveria e asaj kohe, e para vitit 2013, është mundur të tregohet serioze me letra, kurse në realitet as e ka vrarë mendjen ndonjë ditë se ç'bëhet në Shqipëri. Tani, nëse këto të dhëna të Institutit të Statistikave sot nuk janë shifra që flasin dhe tregojnë se dikush duhet të lëvizte nga vendi dhe duhet t'i përgjigjej me metoda

moderne trajtimit të mbetjeve. Sigurisht që kjo pritej dhe u tregua vetëm nga inkuizitorët e rinj që ishin kërkuesit e këtij komisioni hetimor parlamentar.

Në zbatim të detyrimeve të këtij komisioni hetimor, kolegë, ne kemi qenë të vëmendshëm edhe të shikojmë se cila është praktika europiane lidhur me menaxhimin e mbetjeve, meqenëse disa herë u përdor si referencë duke thënë: jo po nuk ka incenerim, incenerimi po bëhet në Shqipëri. Referuar publikimeve shkencore sot, rezulton se në nivel global gjenerohen mbi 2 miliardë tonë mbetje urbane në vit. Shekuj më parë, një mendje universale deklaronte se, ajo që për ne sot quhet mbetje, nesër do jetë lënda e parë. Përvoja europiane tashmë e ka vërtetuar këtë pohim, ndaj prioritet i BE-së është ekonomia qarkulluese, që ka për synim reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin. Në modelin e ekonomisë qarkulluese prodhimi i energjisë nga djegia e mbetjeve radhitet në vendin e katërt. Pra, është diçka që ekziston. Prioritet është parandalimi i gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimi vjen i dyti, riciklimi i treti dhe pastaj incenerimi ose djegia. Kuadri ligjor i Bashkimit European rregullohet e ndryshon në funksion të prioriteteve, duke kufizuar djegien vetëm për ato mbetje, që nuk janë më të ripërdorshme. Në nivelin e Bashkimit European qasjet e shteteve anëtare rezultojnë të jenë të ndryshme në raport me këtë temë. Për shembull, e dini ju se cili është vendi kampion i përdorimit të incenerimit në Europë? Është Danimarka, e cila riciklon rreth 50%, 1% e dërgon në landfill, pjesën tjetër e djeg. Në BE përgjatë viteve 1995 – 2019, është zvogëluar depozitimi i mbetjeve në landfille, nga 121 milionë tonë, në 53 milionë tonë. Ju e kuptoni, landfillet kanë jetë të kufizuar dhe kërkojnë sipërfaqe toke.

Vendet në Europë nuk e kanë këtë mundësi, që të dedikojnë vazhdimisht e vazhdimisht sipërfaqe toke për të zgjidhur problemin e mbetjeve të shtetasve të tyre, për këtë arsye kërkohet gjetja e një metode më efektive dhe jo vetëm kjo. Sasia e mbetjeve të ricikluara dhe kompostuara nga 37 milionë tonë në vitin 1995, u rrit në 107 milionë tonë në vitin 2019. Djegia u rrit nga 30 milionë tonë, në 60 milionë tonë, u dyfishua. Sot në Bashkimin European janë rreth 500 inceneratorë. Cila është mënyra më e mirë e menaxhimit? Sigurisht, nuk na ka ngelur neve ta ndajmë këtë gjë, por më mirë e thonë ata që janë të kësaj fushe. Riciklimi, djegia apo depozitimi është mënyra më e mirë? Praktika në vetvete ka treguar se menaxhimi i mbetjeve nuk është si recetat në gatim. Një model që funksionon në një vend, jo detyrimisht funksionon në një vend tjetër. Kombinimi në masën e duhur i formave të menaxhimit, duke pasur parasysh kriteret mjedisore, ekonomike të tregut, të shëndetit të njeriut, si dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm, do të çonte në zgjidhje optimale. Menaxhimi më i mirë është kombinimi i të gjitha mënyrave, ku prioritet duhet të ketë reduktimi, ripërdorimi e riciklimi i mbetjeve. Në Shqipëri, deri para pak vitesh, mbetjet menaxhoheshin në mënyrën më të keqe, se të gjitha qytetet mbuloheshin nga retë toksike të tymrave, si rrjedhojë e djegies spontane apo edhe me qëllim të mbetjeve. Vendet e pasura, me sipërfaqe toke të kufizuar, si Holanda dhe Danimarka, janë të dyja vende me një ekonomi shumë të mirë, shumë të konsoliduar, i kanë dhënë përparësi riciklimit dhe djegies. Këto vende pothuajse po eliminojnë landfillet.

Si anë pozitive e inceneratorëve përmendet reduktimi i vëllimit të mbetjeve deri në 90%, djegia plotësisht e një pjese të lëndëve toksike, prodhimi i energjisë dhe avullit, si dhe mundësia për të rikuperuar metalet, diçka që e pamë praktikisht sesi realizohej edhe në impiantin e Elbasanit, edhe në atë të Fierit. Duhet të biem dakord, kolegë, që mbetjet nuk janë thjesht dhe vetëm një problem i qeverisë, por janë edhe problem i qytetarëve, i edukimit të tyre. Prandaj unë besoj se kjo çështje edhe

në vijim që do të përbëjë debat, do të kërkojë angazhim, do të kërkojë shumë vëmendje, do të kërkojë përditësim të njohurive, do të kërkojë edhe kërkesë llogarie të shtuar në administrimin si duhet të impianteve, në administrimin si duhet me përgjegjësi të gjithë kësaj çështjeje të madhe, me qëllim për të optimizuar përfitimet dhe ulur kostot, si dhe për të garantuar një cilësi më të mirë të mjedisit dhe natyrisht të jetës dhe shëndetit tonë. Shuma prej 430 milionë eurosh e supozuar si abuzim nga Partia Demokratike, nuk ekziston dhe kjo është lehtësisht e sqarueshme. Si nga dokumentacioni që administruam në komisionin hetimor, por edhe nga dëshmitë e ish-ministrave, sot një pjesë ministra, u provua se shifra prej 430 milion eurosh është një shifër e pavërtetë, e cila ka si qëllim vetëm keqinformimin e publikut dhe nxitjen e tij për të menduar se kjo shumë është vjedhur nga një grup i strukturuar kriminal. Shuma e paguar nga buxheti i shtetit në total është rreth 55 milionë euro, e faktuar kjo nga autorizimet që na ka vënë në dispozicion Thesari i Shtetit.

Në këtë shumë përfshihet pagesa e plotë për impiantin e Elbasanit, 21,6 milionë euro pa TVSH (vepër e ndërtuar dhe është funksionale në të gjitha impiantet dhe prodhon energji elektrike); një pjesë e pagesës për impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier, që ka vlerën totale prej 28 milionë euro pa TVSH (nuk ka në funksion vetëm impiantin e prodhimit të energjisë) dhe për këtë nuk janë paguar rreth 5 milionë euro. Nëse pagesa e plotë e kryer nga viti 2014 deri më tani nga buxheti i shtetit, për ndërtimin e dy veprave është rreth 55 milionë euro, si ka mundësi që dolëm te shifra 430 milionë euro? E pra, ka një mundësi, se ata që kapërcejnë shifrat në matematikë, sigurisht që mund të vijmë edhe te shifra 430 milionë euro. Opozita në komisionin hetimor pohoi se kjo shifër është e parashikuar në kontratë. Pra, sipas logjikës së tyre, shuma që do të paguajnë bashkitë e qarkut Tiranë, në 30 vjetët e ardhshme për pagesën e tarifës së shërbimit, që janë duke marrë sot, prej 29 euro deri në vitin 2047, shuma totale që ato do paguajnë përllëgaritet të jetë rreth 300 milionë euro. Kësaj shume i shtojnë edhe shumën që duhet të investojë koncesionari, rreth 130 milionë euro dhe del 430 milionë euro. Kjo mënyrë e bërjes së llogarive, ose është paaftësi për të cilën kjo forcë politike shquhet, në rastin më të mirë, ose në rastin më të keq është dashakeqësi.

Megjithatë, ne mendojmë se kjo e dyta prevalon mbi të parën, pasi kontrata e koncesionit është 30-vjeçare dhe shuma totale prej 300 milionë euro do të paguhet nga bashkitë deri në vitin 2047, kur mbaron edhe afati i kontratës koncesionare të Tiranës. Ky është një fakt që Partia Demokratike me qëllim nuk ia thotë opinionit publik, por e bën opinionin publik të besojë që afati këtyre kontratave ka mbaruar. Në shumën 430 milionë euro janë futur edhe shpenzimet e ndërtimit, siç e thamë, që do t'i kryejë subjekti privat. Pra, është e qartë se opinioni publik në gjithë këtë periudhë kohe është dezinformuar në mënyrë të përsëritur, nëpërmjet deformimit të fakteve, nëpërmjet deformimit të shifrave dhe më tej akoma atribuit të disa akuzave penale funksionarëve të ndryshëm shtetërorë.

Sa i takon tarifës së dherave vendosur nga këshilli bashkiak i Tiranës dhe pretendimet e ngritura nga opozita, në komisionin hetimor është qartësuar e gjithë kjo histori duke thënë që kjo tarifë është e ndryshme nga tarifat që cakton këshillit bashkiak, sepse bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për shërbimet që ato ofrojnë. Pra, për shërbimet që ofrojnë vendosin tarifa dhe nga tarifat marrin të ardhura. Tarifa vendore sipas ligjit "Për financat e vetëqeverisjes vendore", është një pagesë që individi, personi fizik apo personi juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë si e mirë publike, specifike e përdorur apo një e drejtë e dhënë nga njësitë vetëqeverisjes vendore. Pra, njësitë e

vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për një shërbim që ato ofrojnë apo për një të drejtë që u japin individëve, personave fizikë dhe juridikë.

Në rastin e kontratës së Tiranës, nuk kemi të bëjmë me një tarifë që miratohet nga këshilli bashkiak, pasi bashkia Tiranë nuk është subjekti që ofron një shërbim apo një të drejtë ndaj qytetarëve të saj, por sipas kontratës koncesionare, bashkia vetë një subjekt si çdo subjekt tjetër, duke depozituar mbetjet te koncesionari duhet të paguajë tarifën 29 euro. E drejta e koncesionarit për depozitimin e mbetjeve është një parashikim i kontratës. Pra, as bashkia Tiranë dhe as këshilli bashkiak, nuk kanë kompetencë të vendosin tarifë për një shërbim si ai i depozitimit të dherave, një shërbim që nuk e ofron bashkia Tiranë. Një pjesë e diskutimeve në komisionin hetimor kanë qenë edhe për sa u takon njësitë të zbatimit të kontratave koncesionare. Në raport i gjeni të përshkruara hollësisht, në fakt, sesi ngrihen dhe sesi funksionojnë njësitë e zbatimit të kontratave koncesionare.

Ajo që unë dua të ndaj me ju, është në lidhje me supervizorin. Sipas kontratës koncesionare, supervizori caktohet nga vetë koncesionari. Ai propozon disa supervizorë dhe është njësia e zbatimit ajo që merr vendimin për supervizorin. Sidoqoftë, për ta përmbledhur edhe Tiranën, sipas raportit të përpiluar edhe një herë, në vitin 2012, jetëgjatësia e fushës së Sharrës shkonte deri në vitin 2015, prandaj Tirana u shpall emergjencë mjedisore jo rastësisht dhe jo enkas. Procedura koncesionare është në përputhje me ligjin për koncesionet, sepse trajtimi i mbetjeve duhet të trajtohet me koncesion, thuhet në ligj. Impianti i Tiranës është investim tërësisht privat dhe është kontratë koncesionare që nuk kërkon mbështetje financiare, por i referohet modelit që quhet paper use, pra paguan për shërbimin. Qeverisja qendrore e ka mbështetur në formën e transfertave bashkinë e Tiranës në procesin e menaxhimit të mbetjeve dhe sigurisht do të vazhdojë ta mbështesë bashkinë e Tiranës dhe çdo bashki tjetër të Shqipërisë sa herë që ato të kenë nevojë dhe sa herë që qeveria të ketë mundësi ta bëjë një gjë të tillë, pa asnjë dyshim. Kryetari i bashkisë së Tiranës dhe procedura që ka marrë bashkia Tiranë janë kryer konform ligjeve në fuqi dhe brenda kompetencave që parashikon legjislacioni, bazuar në zgjidhjen e propozuar për menaxhimin e mbetjeve në territorin e bashkisë Tiranë.

Sipas kontratës koncesionare procedura për përzgjedhjen e supervizorit kryhet nga koncesionari, sepse edhe pagesa e tij, në fakt është një pagesë që nuk e bën buxheti i shtetit, por e bën vetë koncesionari. Nuk ka pasur ndryshim kuotash, siç është thënë, për Tiranën, por ka vetëm një ndryshim të emrit, sepse kompania nuk ka ndryshuar, ajo vazhdon të jetë e njëjta dhe ka po ato të dhëna sa i takon Nipt-it, adresës dhe çdo gjëje tjetër. Në lidhje me mbetjet e Durrësit nuk është amenduar kontrata koncesionare e Tiranës, sepse nuk është dashur. Në kontratë, në pikën 2/2 dhe 2/3 të saj përcaktohet: “Me qëllim rritjen e rentabilitetit, maksimalizimit të investimit të koncesionarit, koncesionari ka të drejtë të marrë dhe të furnizohet me mbetje edhe nga njësitë vendore të qarqeve të tjera ose personave të tretë privatë ose publikë, për aq sa kjo nuk cenon përmbushjen e detyrimeve dhe sasisë së mbetjeve urbane që koncesionari ka, sipas kësaj kontrate”. Pra, është krejt e qartë dhe nuk kishte pse të ndryshohej kontrata e Tiranës pse Durrësi është duke e marrë këtë shërbim nëpërmjet impiantit të Sharrës. Në kushtet e emergjencës mjedisore të bashkisë Durrës, sigurisht që është marrë një vendim i mbështetur dhe i analizuar për ta zgjidhur edhe problemin e kësaj bashkie, ndaj së cilës nuk besoj se kemi qenë aq indiferentë sa nuk e kemi parë, se mjaftonte që vetëm në periudhën e verës të shkoje për pushime në Gjirin e Lalëzit dhe gjatë të dielave apo të shtunave, të ndeshje radhën e makinave, të cilat ishin të

detyruara të ngeleshin në trafik, jo për shkak të numrit të lartë të pushuesve, por për shkak të protestave të banorëve atje, sepse rëndom ndodh që askush nuk i do plehrat t'i ketë afër vendit ku banon. Për Durrësin ky problem është i zgjidhur, pasi Sharra është 44 kilometra larg Durrësit.

Leja e ndërtimit është shqyrtuar në Këshillin Kombëtar të Territorit në datën 17 maj 2019, është miratuar me kusht për shkak të plotësimit të dokumentacionit nga koncesionari dhe pas plotësimit të dokumentacionit leja është zbardhur më 24 nëntor 2020. Unë jua solla në vëmendje këtë të dhënë, sepse, siç jua thashë edhe më parë, duke përcaktuar veprimin e autoriteteve shtetërore si veprim të një grupi të strukturuar kriminal i është paravendosur gjithmonë edhe fakti që këta kanë vepruar në nxitim dhe në kohë reale, por dokumentet dhe realiteti nuk flasin kështu. Ka kaluar 1 vit nga koha kur kryetari i bashkisë së Tiranës i ka thënë ministrit të Mjedisit: “Më ka mbaruar funksioni i Sharrës dhe nuk jam unë thjesht si përfaqësues i bashkisë së Tiranës, por kam edhe këto ish-komunat që m’u bashkuan”. Kaloi 1 vit që të arrihej në një propozim të pakërkuar dhe më pas u desh po prapë 1 vit që të bëhej procedura, më pas u desh edhe një kohë tjetër që të zbardhej leja, pra këto nuk janë thjesht procese të thjeshta dhe nuk kanë qenë procese të udhëhequra nga një vullnet i vetëm, i cili të diktonte veprimin e aktorëve të ndryshëm në fushë për të arritur një vendimmarrje të caktuar. Aktualisht, projekti është në fazën e ndërtimit dhe të operimit, e sqarova këtë, landfilli i mbetjeve inerte është pjesë e kontratës së inceneratorit të Tiranës, pra një nga veprat e këtij projekti, ku depozitohen mbetjet inerte të bashkive që mblidhen dhe transportohen nga operatorët ekonomikë privatë apo publikë, çka nënkupton që përcaktimi i tarifës për këto mbetje është një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet koncesionarit dhe operatorit ekonomik.

Besoj se askush në këtë sallë nuk pretendon që koncesionari mbledh edhe mbetjet, sepse këtë funksion e realizojnë bashkitë, bashkitë i dërgojnë tek impiantet dhe pastaj janë njerëzit që ndodhen aty ata që operojnë me mbetjet. Tarifa 29 euro për ton është një çmim mesatar i ponderuar, që është vendosur pas një analize të studimit të fizibilitetit që i paraprin kontratës. Këto lloj çmimesh mesatare të ponderuara janë instrumente financiare që përdoren për t’i dhënë një kurbë sa më të zbutur një koncesioni dhe për mos e goditur atë gjatë momentit kur do të nisë incenerimi. Në Tiranë pjesë e rëndësishme është impianti i prodhimit të energjisë elektrike. Ne ishim vetë atje dhe na u shpjegua se do të ndërtoheshin dy godina të tilla ku do të bëhet incenerimi. Në qoftë se e vutë re, unë nuk e kam përdorur shumë shpesh fjalën “incenerator”, por jam referuar duke thënë “impiant”, sepse kjo është e vërteta, ndërkohë që opozita vazhdimisht ka folur vetëm për inceneratorë dhe asnjëherë nuk ka folur për impiante, duke mos e vënë asnjëherë këtë fjalë në gojën e saj dhe e ka bërë qëllimisht, sepse ka dashur që gjatë gjithë kohës, për t’iu përmbajtur gënjeshtërs që sajoi, të zvogëlonte edhe tërësinë e funksioneve që kryejnë këto impiante, sepse kështu mund të justifikoheshin më mirë akuzat që i janë provuar publikut. Po vij te pjesa fundore, ajo që mund të deduktohet si konkluzione apo si sugjerime të këtij raporti. Ky hetim pa dyshim ishte një hetim kompleks.

Një ligj i vitit 2002 pas 20 vjetësh, sigurisht që nuk i qëndron më kohës, nuk lidhet aspak me reformën në drejtësi, e cila një ndër synimet kryesore që pati ishte pikërisht largimi i politikës nga drejtësia, jo në kuptimin formal, në atë të zgjedhjeve, të krerëve, të pushtetit të drejtësisë, por në kuptimin substancial të ndarjes një herë e mirë të politikës nga pushteti gjyqësor dhe të heqjes së atij prezumimi që qenia deputet të bën automatikisht të lidhur dhe që t’i ndikosh këto autoritete. Ligji, sikundër lexohet sot, për

komisionet hetimore, nuk e garanton dot mosshkeljen e parimit të rëndësishëm kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ndonëse e afirmon dhe ky është cedimi më i rëndë dhe që natyrisht ne nuk duhet ta lejojmë më të ndodhë. Për këtë arsye ne i propozojmë Kuvendit të Shqipërisë të bëjë një rishikim tërësor të ligjit, duke iu përmbajtur Kushtetutës, duke e ruajtur parashikimin kushtetues të nenit 77, paragrafi 2, që ka të bëjë me të drejtën për të ngritur komisione hetimore, ndërkohë që e drejta për ngritjen e komisioneve hetimore përmes një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese është afirmuar si një e drejtë e opozitës, pra ta ruaj këtë të drejtë, por sigurisht ne të kujdesemi që duke e riparë ligjin të ofrojmë një projekt, i cili të mund të sigurohet përmes mekanizmit të vet të ndërtimit, pra pikërisht respektimit të këtyre parimeve. Këtë nuk na e bën dot vota në Kuvend, sepse vota në Kuvend është votë politike, vota në Kuvend është votë që i referohet një momenti dhe jo detyrimisht vota në Kuvend garanton edhe parimet e rëndësishme kushtetuese, përfshirë këtu parimin kryesor, atë të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve.

Bashkëngjitur këtij raport i kemi edhe gjithë dokumentacionin e administruar në komisionin hetimor, sepse mendojmë që është një dokumentacion që mund t'i shërbejë shumë mirë edhe hetimit që është duke u zhvilluar nga organi i ndjekjes penale në lidhje me çështjet në fjalë si pasojë e kallëzimeve tuaja. Kjo është arsyeja që veç sugjerimit që ne kemi për rishikimin e ligjit për komisionet hetimore brenda kësaj legjislatore, sugjerojmë po ashtu, duke pasur parasysh nenin 77/2 të Kushtetutës, ku parashikohet që përfundimet e komisioneve nuk janë detyruese për gjykatat, por ato mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila vlerëson sipas procedurës ligjore, që ky raport i përfaqësuesve të maxhorancës në këtë komision, bashkëlidhur këtij edhe i gjithë dokumentacioni që ne kemi mbledhur në komisionin hetimor, t'i dërgohen prokurorisë së posaçme, duke besuar që me sjelljen tonë, për aq sa na takon, i jemi përmbajtur respektimit të parimeve kushtetuese. Në mbyllje të fjalës sime, do të dëshiroja edhe një herë të falënderoja kolegët e mi të maxhorancës, përfaqësues në këtë komision, për të gjitha orët e zgjatura, për gjithë durimin e treguar edhe ndaj qëndrimeve cinike të kolegëve të opozitës! Duhet të kuptoni që qëndrimi ynë aty ishte pikërisht që t'i mundësonim publikut të shihte të vërtetën, e vërteta nuk është diçka që mbahet në dorë, e vërteta është një gjë që duhet të kërkohet për ta zbuluar dhe besoj që kemi bërë maksimumin për ta sjellë të vërtetën para publikut. Patjetër që kjo është një eksperiencë e mirë për çdo ligjvënës. Këtu dua të marr shkas nga fjala e koleges sime, zonjës Denaj, e cila tha që për mua si një eksperiencë e parë ishte shumë e mirë. Besoj krejtësisht se kjo është e sigurtë dhe duhet, sepse duke qenë aktivë në punën si të zgjedhur ne kemi mundësi të kuptojmë më mirë jo vetëm si duhet të komportohemi në raport me ligjin dhe me Kushtetutën, por kemi mundësi të kuptojmë më mirë përgjegjësitë tona në raport me ligjin dhe përgjegjësit tona janë ato të rirreflektimit të një ligji apo ndaj ligjeve, të cilat nuk sigurojnë respektimin e parimeve themelore që përmban ligji themeltar i Republikës së Shqipërisë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Faleminderit edhe një herë për vëmendjen!